




Sikur të isha kryetar komune





Ky publikim është pjesë e projektit "Sikur të isha kryetar komune" dhe i cili u mbështet nga Këshilli i Evropës. Pikëpamjet e paraqitura në këtë publikim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht edhe qëndrimin e Këshillit të Evropës.

"Sikur të isha kryetar komune"

Asociacioni i Komunave të Kosovës

Rr. "Gustav Mayer" Nr.5

Prishtinë


Tel. 038 245 734

Fax. 038 245 732

info@komunat-ks.net

www.komunat-ks.net

Prishtinë, korrik 2009



Fjala e kryetarit të AKK-së

Është një kënaqësi tepër e veçantë kur të ipet mundësi që të punosh për qytetarët Tuaj. Pra, për ata qytetarë që me vite keni jetuar e punuar së bashku, keni ndarë format dhe mënyrën e jetesës në lokalitetin tuaj dhe keni plane të përbashkëta për të ardhmen.

Aktivitetet e përditshme të pushteti lokal tregojnë se shumë gjëra mund të rregullohen dhe përmirësohen për të pasur një qytet më të pastër, për më shumë parqe, shkolla, lulishte, fusha lojërash dhe për të krijuar një jetë të qytetarëve sa më të lehtë.

Asociacioni i Komunave të Kosovës ka inkurajuar gjithmonë forma të pjesëmarrjes qytetare në komunat tona për të rritur kontributin e qytetarëve në qeverisjen lokale dhe për të përmirësuar përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e këtyre organeve ndaj qytetarëve.

Andaj me këtë ide ne tentuam që edhe studentëve dhe qytetarëve të thjeshtë të iu ipet mundësia që së paku si vizion të pasqyrojnë idetë e tyre dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë të na ndihmojnë ne në punët tona të përditshme dedikuar qytetarëve tanë.

Asociacioni i Komunave të Kosovës u është mirënjohëse së pari të gjithë atyre që morën pjesë në këtë projekt. Ata kontribuan përmes shkrimit të eseve të tyre duke dhënë mendime të çmuara, që mund t'u vijnë në ndihmë kryetarëve të komunave të Kosovës dhe mund të gjejnë zbatim të mundshëm në jetën e përditshme.

Gjithashtu falënderojmë të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues për vlerësimet e tyre, përmes të cilave, edhe ndikimin drejtë përzgjedhjeve më të mira në mënyrë që para kryetarëve të komunave të kemi versione dhe ide të ndryshme për punën e tyre të përditshme.

Ndërsa në fund uroj që kryetarët e komunave dhe udhëheqësit tjerë lokal ta përdorin këtë publikim në të mirën e tyre dhe qytetarëve të komunave të tyre.

Dr. Bajram Rexhepi

Përmbledhja ekzekutive

I konceptuar që të jetë tërësisht në shërbim të kryetarëve të komunave, projekti "Sikur të isha kryetar komune" duket se ka dhënë efektet e para që në fillim të tij. Fjala është për një debat të nxitur e që më herët as që është menduar. Pra sikur unë të isha kryetar komune, për çfarë në fakt do të angazhohesha?

Ky projekt i Asociacionit të Komunave të Kosovës që gjeti mbështetje të plotë nga Këshilli i Evropës u realizua brenda periudhës së përcaktuar dhe sipas planifikimeve. Fillimisht u përcaktuan kriteret për paraqitjen e ideve në ese në përputhje me kriteret e përcaktuara të një qeverisjeje të mirë lokale ku kryetari i komunës vepron duke zbatuar ligjin dhe duke përmbushur interesat dhe kërkesat e qytetarëve.

Kriteret bazike për ese ishin: a) roli i lidërshiptit, b) cilësi e mirë ndaj shërbimeve për qytetarët dhe c) pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje. Pas shpalljes së konkursit dhe përcaktimit të Komisionit vlerësues u përcaktuan edhe kriteret për seleksionim. Vlen të ceket se ndër kriteret bazike për seleksionim dhe poentim të esëve ishin: risia, efikasiteti, kualiteti, zbatueshmëria dhe qëndrueshmëria e idesë.

Me këtë rast duhet të falënderohet Komisioni vlerësues në përbërje: z.Naim Ismajli - përfaqësues i Bordit të AKK-së (kryetar i komunës së Shtimes), znj.Rozafa Ukimeraj - Drejtore e Departamentit për vetëqeverisje Lokale në MAPL, z.Agron Maxhuni - ekspert i pavarur, z.Enver Hasangjekaj - ekspert i pavarur.

Projekti pranoi gjithësj 53 ese në temën e përcaktuar. Pas vlerësimeve të anëtarëve të Komisionit ne arritëm të nxjerrim tri vendet e para: z.Gëzim Qerimi me 93 pikë, z.Ragip Gjoshi - 88 pikë dhe znj.Vjosa Ibishi me 87 pikë. Poashtu kemi përzgjedhur edhe 20 esetë tjera më të mira të cilat i kemi botuar në këtë publikim.

Si vazhdimësi të idesë së këtij projekti dhe krijimit të një familjarizimi mes autorëve fitues dhe kryetarit të komunës ne kemi planifikuar që autorët fitues do të shoqërojnë kryetarin e komunës për një ditë të plotë dhe të ndihmojë atij në të gjitha vendimet, takime pune etj.

Falënderojmë edhe një herë Këshillin e Evropës të cilët mbështetën këtë projekt si dhe nuk hezituan për asnjë moment që të na ndihmojnë në implementimin e këtij projekti, duke bartur përvojat e tyre tek ne nga shumë shtetet të Evropës.

Arsim Osmani
Menaxher i Projektit

1

Vendi i parë

GËZIM QERIMI - “Sikur të isha kryetar komune”**Roli i lidërshiptit (Vizioni dhe strategjia)**

Duke pasur parasysh sfidat që kanë kryetarët e komunave të Kosovës rreth qeverisjes lokale, vlen të theksohet që një prej faktorëve në qeverisjen e mirë është lidërshipti që drejton qeverisjen e Komunës. Në këtë kontekst, vlen të ceket se lidërshipti ka rolin bazik në përgatitjen përfundimtare të vizionit dhe strategjisë së qeverisjes së komunës. Në këtë kontekst, unë, “sikur të isha kryetar komune”, në radhë të parë do të formoja një grup punues që do të përbëhej nga ekspertët më të mirë të komunës sonë. Gjithë ekspertët e këtij grupi punues do të duhej që të kishin përgatitjet e tyre profesionale dhe shkollimin superior në fushat e caktuara. Ky grup, duke u bazuar në njohuritë e tyre profesionale dhe shkencore, do të hartonte vizionin dhe strategjinë e qeverisjes për komunën tonë, për periudhën katërvjeçare. E domosdoshme do të ishte edhe pjesëmarrja e ndonjë eksperti ndërkombëtar në këtë grup punues, pasi ai do të mund të sillte praktikën e mira të qeverisjes evropiane. Vizioni dhe strategjia do të plotësohej dhe riformohej edhe nga diskutimet me të gjitha kategoritë e qytetarëve, të cilët do të shprehnin sugjerimet e tyre se cili duhet të ishte vizioni dhe strategjia e komunës për qeverisjen në këtë periudhë.

Vizioni dhe strategjia ime, në pika shumë të shkurtra, do të ishte:

Një komunë moderne, me një zhvillim të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm, duke u bazuar në qeverisjen e drejtë, në partneritetin e mirëfilltë me institucionet qendrore të Republikës së Kosovës, si dhe në mbështetjen dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Strategjia dhe vizioni im si kryetar do të ishte: ambient i përshtatshëm për biznes, ndërmarrësi të fortë, të bazuar në iniciativën private, për të shfrytëzuar resurset në lëmin e bujqësisë, turizmit, prodhimeve dhe shërbimeve tradicionale, e shoqëruar nga një administratë lokale efikase dhe e pakorruptuar, e cila do të ofronte shërbime të mira për të gjithë qytetarët pa dallim. Qeverisja jonë do të përkrahte dhe do të nxiste në mënyrë aktive rritjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, në funksion të rritjes së cilësisë së jetesës së qytetarëve. Qeverisja do të bazohej në vazhdimësi në zhvillimin e politikave të gjithmbarshme, ku do të sigurohej qëndrueshmëri politike, siguri dhe rend për të gjithë qytetarët, liria e shprehjes, e drejta e pronës, mbrojtja e të gjitha të drejtave dhe lirive të njeriut, të sanksionuara me konventat ndërkombëtare, e në veçanti do të zhvilloja politikën e diskriminimit pozitiv për minoritetet që ka komuna. Gjithashtu, prioritet do të kishte zhvillimi i ekonomive familjare, mirëqenia sociale, shërbimet shëndetësore. Arsimimi, kultura dhe sporti do të ishin krenaria e komunës, duke treguar më së miri zhvillimin e gjithmbarshëm të komunës sonë.

Cilësi e mirë ndaj shërbimeve për qytetarët

(Risi për përmirësimin e shërbimeve, transparencës dhe luftës ndaj korrupsionit)

- Shërbime publike dhe administrative efikase, duke u bazuar në E-Qeverisje, përkatësisht digjital-

izimi i tërë administratës komunale, e cila do të ofronte aplikime online nga shtëpia për certifikatat e lindjes, letërnjoftimet, pasaportat dhe të gjitha dokumentet e tjera.

- Digjitalizimi i Gjykatës Komunale, ku secili qytetar do të kishte qasje të drejtpërdrejtë në lëndën që ka paraqitur në Gjykatën Komunale, se: kur është pranuar lënda, kur është shqyrtuar dhe cili është vendimi i gjykatës.

Ky digjitalizim i administratës së gjykatës komunale, përfundimisht, do të luftonte krimin e organizuar që shumë herë tenton ta korrumpojë edhe gjykatën komunale, deri të rastet më ekstreme duke zhdukur edhe dosje të shumta.

Të gjitha këto veprime do të sillnin risi për përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, si dhe do ta rrisnin transparencën e strukturave komunale në raport me qytetarin. Këto veprime, pa dyshim, do të ishin hapa konkretë për luftimin dhe zhdukjen e korrupsionit.

Lufta ndaj korrupsionit dhe transparenca

Arsyeja pse korrupsioni lulëzon në sistemin tonë është, kryesisht, për shkak të mungesës së transparencës. Transparenca do të ishte ajo që do të përbënte hapin e madh drejt shoqërisë, me njerëz të dalluar për vlerën dhe ndershmërinë e tyre, pavarësisht se për këto e rrahin gjoksën të gjithë. Në kuadër të transparencës, komuna do të mbështesë fuqishëm dhe do të punojë në ngritjen e medieve të fuqishme dhe të pavarura lokale, duke siguruar pavarësimin e tyre, e në asnjë rast devaluimin e tyre për interesa personale apo politika ditore. Sikur të isha kryetar komune, unë nuk do ta kisha kuptuar mandatin tim pa një TV-lokale të fuqishme dhe të pavarur, radio dhe gazetë, së paku javore, si dhe institucione të tjera mediale të pavarura, që do të ishin në shërbim të qytetarëve, pavarësisht se kush do të ishte kryetar komune sot e kush do të jetë nesër. Kjo do të çonte në standardizimin e mënyrës qeverisëse për komunën. Kjo transparencë duhet të ndihmohet gjithashtu dhe nga kërkesa për një presion të fortë nga grupet shoqërore në vend, për izolimin e njerëzve të korrumpuar. Ndiurma e tyre konkrete do të ishte botimi i listave me njerëz të korrumpuar, që kanë mundur t'i identifikojnë. Nëse ky material do të konsiderohej me vlerë ai duhet të prezantohet në organet që janë të ngritura për këtë qëllim. Lufta ndaj korrupsionit bëhet në front të gjerë, ku armiku është i dukshëm (pjesëtarët e lidhshëm komunal dhe sistemi gjyqësor) dhe i padukshëm (ajo pjesë e politikanëve të korrumpuar, por që janë në opozitë, si dhe grupet e shumta të interesit që janë të lidhura me strukturat komunale).

Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje

Sikur të isha kryetar komune projekti im do të fokusohet tek përpjekjet për t'iu adresuar një prej kushteve më të rëndësishme për një qeverisje lokale të hapur, transparente dhe të përgjegjshme – përfshirjen e qytetarëve në qeverisjen vendore. Kjo iniciativë pason eksperiencën dhe praktikën time më të mirë të krijuar nga vizita dhe studimi i shkurtër i qeverisjes lokale në Norvegji, në vitin 2006. Ky projekt do ta përmirësonte qeverisjen lokale nëpërmjet konsolidimit të rolit të komunitetit në proceset e vendimmarrjes lokale, si edhe nëpërmjet krijimit të një modeli novator të bashkëpunimit midis autoriteteve lokale dhe qytetarëve të komunës, nëpërmjet qendrës që do titullohej Qendra "KOMUNITARE" (Komunë – Komuna dhe itare – Komuniteti – Qytetarët) ku do të zhvilloheshin takime, seminare, tribuna dhe konferenca nga lidhshëmi i komunës me të gjitha grupet shoqërore, duke filluar nga grupet sociale, shëndetësore, arsimore, ekonomike, kulturore, sportive, rinore, pensionale, si dhe të gjitha grupet e tjera që mund të ketë komuna. Synimi i kësaj qendre do të mundësonte pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje, duke ndikuar drejtpërdrejt në hartimin dhe zbatimin e politikave komunale.

Projekti, gjithashtu, synon të ndihmojë përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe aktorëve të interesuar lokalë të përmirësojnë mobilizimin e qytetarëve, aktivitetet vullnetare dhe iniciativat me bazë të gjerë, me qëllim që të rritet pjesëmarrja qytetare në vendimmarrjen lokale për çështjet e rëndësishme për qytetarët dhe standardin e tyre të jetesës. Bashkëpunimi midis komunës dhe qytetarëve

do të përbënin çështjet kryesore ku do të fokusoheshin aktivitetet e projektit dhe, për këtë qëllim, strukturat komunale do të shërbenin jo vetëm për identifikimin dhe artikullimin e problemeve të qytetarëve, por edhe për zgjidhjen e tyre nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në proceset lokale të politik-bërjes dhe vendimmarrjes së tyre në komunën ku jetojnë.

Po të isha kryetar komune, unë nuk do kuptoja mandatin tim pa një mirëqenie të domosdoshme për të gjithë qytetarët, ku do të përfshihej: furnizimi me ujë pa ndërprerje duke shfrytëzuar të gjitha kapacitetet njerëzore si dhe burimet ujore të dhuruara nga Zoti për mirëqenien e njerëzimit; rrugë më të mira; qytet më të pastër; më shumë parqe dhe ambiente të gjelbëruara dhe shërbime administrative të kulturuara. Këto janë ambiciet e mia thelbësore që përbëjnë motivin tim politik të programit, sikur të isha kryetar komune.

Në përfundim, unë, "sikur të isha kryetar komune", gjithmonë do të punoja dhe do të veproja duke zbatuar ligjin dhe duke përmbushur interesat dhe kërkesat e qytetarëve.

Për ta bërë realitet vizionin e një kryetari komune për qeverisje efektive dhe të ndershme, do të bazohesha në konsolidimin e reformës për qeverisje moderne lokale, të mbështetur në një plan veprimi të orientuar në katër aspekte: 1. Kushtetues; 2. Ligjor; 3. Institucional dhe 4. Praktik.

2

Vendi i dytë

RAGIP GJOSHI - “Sikur të isha kryetar komune”**“Vendet më të errëta në ferr janë të rezervuara për ata që ruajnë neutralitetin në kohë të krizës morale”. Dante Alighieri (1265 – 1321)**

Kjo sentencë e poetit më ka motivuar që edhe unë intelektin, përvojën dhe energjitë e mia, në këto kohë delikate të ndërtimit të shtetit tonë të ri, t'i vë në shërbim të qytetarëve. Motiv shtesë, që të prezantoi pikëpamjet e mia për ndryshimin e pamjes së qendrës komunale dhe vendbanimeve të sajë; për ndryshimin e stilit të qeverisjes lokale; është edhe qasja e deritashme e pamjaftueshme dhe strategjia jo adekuate për zhvillimin ekonomik të komunës; përkushtimi i pamjaftueshëm për ofrimin e shërbimeve publike sa me efikase që t'u ngjajmë sadopak komunave të ndonjë vendi perëndimor apo së paku atyre të rajonit. Madje, motiv paksa më i veçantë shtesë për përkushtimin tim si kryetar imagjinar i Komunës janë zgjedhjet e tanishme ligjore me kompetenca më të fuqishme për kryetarin e komunës, si dhe pamjet në qendrën komunës me ndërtimet pa leje që i zënë frymën ardhmërisë, mbeturinat në çdo cep nuk janë problemi i vetëm me të cilin nuk merret askush, rrugët e trotualet qendrore të qytetit, mbrëmjeve nuk janë të ndriçuara për faktin që përgjegjësit për mirëmbajtjen e tyre duket se kanë punë më të “meçme”! Përkushtimi im për të qenë i pari i komunës është shqetësimi për pluhurin që ngrihet kudo e që ngjyrosë rrobat e trupit derisa tymtarët e termo-elektranave vjellin helm, ndotja e paskrupullt që i bëhet lumenjve; rrugët në qytetit dhe ato të lokaliteteve rurale që janë të mbushura me gropa nga më të ndryshmet, përderisa “tëhollohet” pamëshirshëm “peta” e asfaltit nga menaxhuesit e tenderëve, të cilat më pastaj e kanë vështirë dhe të “arnohen”. Janë këto disa nga motivet që më joshën që përmes këtij prezantimi publik të ofroi diçka të re në interes të qytetarëve të të komunës.

Roli i lidërsipit (Vizioni dhe Strategjia)

Zgjedhjet lokale janë një mundësi e mirë që qytetarët që të zgjedhin një kryetar të mirë për të ju shërbyer, për të krijuar rend, sundim të ligjit dhe rregull në qytet. Dhe unë bagazhin tim intelektual do ta vë në shërbim të qytetarëve për të qenë një kryetar komune, i cili do të menaxhoj mirë paranë publike me shërbimet publike dhe ato komunale sa më efektshëm e më racionalisht. Sapo unë si kryetari i ri, i cili do të fitoj besimin e qytetarëve për pushtetin lokal, fillimisht me veprime konkrete në të gjitha lokalitetet e komunës do të organizoja takime të drejtpërdrejta me votuesit që ata së pari deklarativisht e madje edhe me Program pune dhe me projekte konkrete t'i bindja se do t'i shuaja klanet provinciale që kanë mbytur demokracinë dhe shërbimin për qytetarët. Do të bëja përpjekje për të rikonfirmuar besueshmërinë që do t'i zhbëja klanet e grupet e interesit që kanë krijuar struktura të forta të korrupsionit në çdo segment, duke filluar nga kontratat me ndërmarrjet e ndryshme, tenderët për infrastrukturë dhe gjithçka tjetër, pronën publike, lejet e ndërtimit, shërbimin e inspeksionit dhe segmente të tjera. Pra, fillimisht do të më duhej që t'i bind qytetarët se do të ndryshojë shumëçka në raport me përgjegjësin që do të më ngarkohej që para tyre të krijohet përshtypja, por dhe bindja se Kryetari i ri i zgjedhur do të lirohet nga një pjesë e mirë e stafit të drej-

torëve aktual të departamenteve komunale, drejtorët e ndërmarrjeve komunale dhe kthimin e rregullit në ballë të arsimit komunal, shëndetësisë dhe shërbimeve tjera. Pa krijimin e një ekipi menaxherial me aftësi të dëshmuara profesionale dhe me etikë e besueshmëri nuk do të luftohej korrupsioni dhe nuk do të evitoheshin dështimet, nuk mund të pritët kthimi i rregullit në qytet dhe në shërbimet vartëse. Konsideroj se do të jem një kryetar komune i suksesshëm si leadership, sepse posedoj me përvojë të dëshmuar, me aftësi të dëshmuara si drejtues në institucione arsimore, në ballë të luftës çlirimtare, si epror i TMK-së, si publicist, si zëdhënës i komunës, si aktivist shumëvjeçar politik dhe së fundi si drejtues i njërit nga departamentet më të rëndësishëm në pushtetin lokal. Strategjinë time do ta ndërtojë mbi premtimet paraelektorale të ndërtuara mbi bazën e potencialit buxhetor dhe kadrovik të komunës, të ndërtuara mbi gatishmërinë time për të marrë vendime të forta dhe i guximshëm për të ju qasur të gjitha sfidave dhe aq shumë problemeve me të cilat ballafaqohet sot pushteti lokal. Mbi këtë bazë në strategjinë time si vizion do të fokusoheshin; vënia e rregullit urbanistik, lidhja e të gjitha fshatrave me rrugë të asfaltuar, ndërtimi i objekteve shkollore dhe shëndetësore ku ato mungojnë, ndërtimi i ujësjellësve dhe kanalizimeve në fshatrat ku mungojnë, ndërtimi i qendrave të ofiçarisë nëpër të gjitha bashkitë e komunës, përkujdes për familjet e dëshmorëve dhe të gjitha kategoritë sociale, përkujdes për ujërat e zeza, hapësirat publike, ndriçimin publik dhe rrugët e transportin lokal. Të gjitha këto vizione të strategjisë sime, jam i bindur që përmes Programit tim të punës dhe projekteve detaje të aprovuara nga përfaqësuesit e popullit në Kuvendin e komunës do të mund të krijonin sundim të ligjit, rregull dhe stabilitet, sikurse edhe shërbime efikase për qytetarët.

Cilësi e mirë ndaj shërbimeve për qytetarët

Fakti që zgjedhja e kryetarit bëhet me votat e drejtpërdrejta të qytetarëve është një mundësi reale që të bëjmë ndonjë ndryshim nga udhëheqja e kaluar. Duke qenë njohës i mirë i rrethanave dhe gjithë organizmit të pushtetit lokal, është një dëshmi që unë do të lë anash lokalizmat, do t'i lë anash votat për anën partiake dhe gjithashtu besimin e krijuar si autoritet apo të tjera. Projekti im si kryetar i ri do të përballej me luftimin e burokracisë dhe shërbimeve jo-efikase komunale, shërbimeve publike të nivelit të ulët: transport publik, ujën e pijes, larjen e rrugëve, ndriçimin publik dhe shumë shërbime të tjera. Madje, risi në të mirë të qytetarëve do të ishte zëvendësimi i dështimeve në realizimin e planeve urbanistike, në legalizimin e ndërtimeve ilegale të cilat nuk dëmtojnë Planin hapësinor dhe atë detal urbanistik, në lirin e pronave publike të uzurpuara, në favorizim të bizneseve të suksesshme, por jo në mënyrë selektive dhe dhënie të lejeve të ndërtimit për ata që plotësojnë kriteret ligjore dhe jo zvarritjen e tyre, do të përkushtohem në urbanizimin dhe gjetjen e donacioneve për Projektin e Lagjes së familjeve të dëshmorëve dhe veteranëve të luftës së UÇK-së ndarjen e banesave pa kriterë. Pra, defektet e deritashme na shtyjnë të mendojmë se na duhet një qasje tjetër, një qasje që ka të bëjë me interesin e jetës sonë të përditshme dhe ardhmërisë së komunës. Po ashtu, përveç takimeve të rregullta me mediat dhe publikun do të organizoja transmetimin e drejtpërdrejt të punimeve të Kuvendit të komunës, do të organizoja debate e tryeza ku do të identifikoheshin prioritetet e preokupimet e qytetarëve, do të organizoja konferenca për shtyp dhe do të isha i hapur për media. Ndërkaq, sa i përket luftës ndaj korrupsionit, për çrrënjosjen e kësaj të keqe do të aktivizoja organet e revizionit të brendshëm dhe do të bashkëpunoja me organet e ndjekjes dhe të drejtësisë, sepse kjo do të hapte perspektivë ardhmërisë dhe zhvillimit ekonomik të komunës dhe do të reflektonte një shembull të mirë të qeverisjes.

Pjesëmarrja qytetare në vendim-marrje

Që mos të ngulfatet zëri i qytetarëve dhe sidomos shoqërisë civile, do të bashkëpunoja me OJQ-të lokale që ato të angazhohen në luajtjen e një roli më të rëndësishëm për të vetëdijësuar votuesit, sepse ata kanë nevojë të informohen drejt se çka kërkon pushteti lokal. Unë si një kryetar i zgjedhur për epitetin e një kryetari që do punën dhe që është i përkushtuar për qytetarin dhe interesin e tij do të krijoja kushte që qytetarët të kenë mundësi të marrin pjesë në punën e Bordit të drejtoreve,

në punën e Komitetit për Politikë e Financa dhe komiteteve të tjera, që të marrin pjesë në punimet e Kuvendit të komunës dhe kështu qytetari të jetë bashkëpjesëmarrës në vendime të rëndësishme. Edhe për shoqërinë civile do të krijoja ambient të mirë që ajo të luaj një rol të rëndësishëm që në kohën e fushatës për zgjedhje edhe për të hulumtuar të kaluarën e kandidatëve, përkushtimin për qytetin, pasurinë e tyre (prejardhjen e saj), reputacionin e tyre të qytetarët, komunitetin e artistëve, nxënësve dhe të tjerëve. Por, e kaluara duhet të hulumtohet dhe të publikohet gjithsesi edhe për të propozuarit për anëtar të kuvendit të komunës. Kjo për faktin që sot kemi anëtar të komunës me të kaluar të dyshimtë, pa reputacion të qytetarët, anëtar që qytetari është interesi i tyre i fundit, uzurpues të pronave publike, ndërtues të rrokaqiejve pa leje dhe marifetllëqe të tjera, që në asnjë mënyrë nuk meritojnë të jenë përfaqësues të qytetarëve.

Unë si Kryetari i komunës, pasi të bëjë identifikimin e problemeve, sipas prioriteteve do të bëjë stopimin e ndërtimeve pa leje të reja, harmonizimin e legjislacionit dhe nxjerrjen e akteve nënligjore (rregulloreve) pa shkelur ligjin për vetëqeverisjen lokale dhe gjithnjë duke pasur në mendje Ligjin mbi qasjen në dokumente zyrtare. Vlerësoj se është koha që të kemi një kryetar komune komunikues dhe një staf tjetër të pastër dhe bashkëpunues. Krejt në fund, më duhet të konstatoj se injoranca dhe mospranimi i realitetit nuk i bën nder besimit të dhënë nga ana e qytetarëve. Andaj në çdo fazë të qeverisjes sime gjatë mandatit do të jem i gatshëm të përballem me qytetarin dhe me përgjegjësitë e ngarkuara dhe do të bëjë përpjekje që profili im prej kryetari të jetë model i mirë në vend.

3

Vendi i tretë

VJOSA IBISHI - "Sikur të isha kryetare komune"

Duke pasur parasysh rëndësinë kruciale që ka kjo tematikë për tu trajtuar në shoqërinë kosovare, dhe natyrisht për të parë në vetvete elementet kyçe se cilat do të ishin vendimet dhe aktivitetet që do ndërmerren po të gjendesha në një pozicion të tillë, më ka shtyrë dhe më ka motivuar të trajtojë me më seriozitet këtë temë interesante e cila ngërthen në vete krijimin e imagjinatës dhe plasimin e asaj imagjinate në aktivitete të mundshme.

Kryesisht e cilësoj temë interesante dhe të nevojshme për tu debatuar, ngase perceptimi aktual në Kosovë nuk i gëzon qytetarët e saj. Në këtë esë të shkurtër e cila nuk mjafton për të prezantuar të gjitha elementet e nevojshme, mirëpo do të paraqesë në fokus disa nga më kryesoret.

Koïncidentalisht lexova një intervistë të dhënë nga kryetarët e komunave lidhur me trajtimin e kësaj teme, të cilën ata e kategorizuan si të panevojshme, të them të drejtën edhe unë do ta quaja të atillë, por jo në situatën dhe gjendjen e tanishme.

Roli i Lidershipit (Vizioni dhe Strategjia)

Kosova aktualisht po përjeton një fazë tranzicioni, e cila domosdoshmërisht vë në pah disa elemente, të panevojshme për një shtet të ri siç është Kosova.

Disa faktorë të cilët aktualisht janë pjesë e procesit, janë duke prolonguar ecjen e shtetit para, ato gjithsesi ndërlidhen me rolin e lidershipit, ngase lidershipi është ai që duhet të krijojë vizionin dhe strategjinë për të udhëhequr një komunë.

Lidershipi është figura dhe pasqyra kryesore. Përse e quaj të tillë? Ngase, lidershipi ka mundësinë që të vetëpërcaktohet, ta kategorizojë vetveten. Vetëpërcaktimin e tij e konceptojë në dëshirën e tij se a ekziston vullneti të ruaj ndershmërinë dhe të punojë në parimin esencial e të qenurit i ndershëm me qytetarët e tij, apo e përcakton vetveten tek shfrytëzimi i pozitës së tij për interesa të caktuara. Në rast se lidershipi vendos të punojë në parimet e ndershmërisë atëherë krejtësisht lehtë, krijohet vizioni dhe strategjia.

Të jesh kryetar i një komune është nder dhe përgjegjësi. Nder për besimin e dhënë i cili në të shumtën e rasteve është tradhtuar në rastin e Kosovës, dhe përgjegjësi për fjalën e dhënë. Ti bashkërendosh këto dy komponentë do të thotë ta arsyetosh vetveten dhe votën e marrë nga qytetarët. Ngase këto janë elemente të ndërlidhura ngushtë mes vete.

Strategjia krijohet, në rastin kur bëhet identifikimi i nevojave të qytetit përkatës. Strategjia duhet të posedojë këto komponente:

- Identifikimin e problemeve dhe nevojave
- Mundësinë e zgjidhjeve të tyre,
- Sigurimin e mjeteve për realizimin e objektivave në strategji.

I tërë problemi esencial në Kosovë është se nuk bëhen shpenzime të duhura, dhe nuk identifikohen prioritetet, andaj edhe vie deri tek shfrytëzimi jokorrekt i linjave buxhetore.

Prandaj është i pajustificueshëm suficiti në fundin e vitit fiskal.

Çka do të thotë se ka moskoordinim të kërkesave për mjetet buxhetore. Dhe në këtë pikë roli i lidershit ka impakt dhe rëndësi të madhe, sepse kërkohen mjete buxhetore shtese përderisa ka suficit, e cila qon në konkludimin se nuk ka racionalitet të shpenzimeve.

Cilësi e mirë ndaj shërbimeve për qytetarët

Në këtë pjesë të temës do të trajtojë disa elemente kyçe, sepse është e pamundur të trajtosh problemet e një qyteti në një ese të shkurtër, mirëpo do të potencoj ato nga më të domosdoshmet në përmbushjen e detyrimeve që ka udhëheqja komunale ndaj qytetarëve.

- Administrimi publik, shërbimet publike që nënkupton: siguria, ekonomia, shëndetësia, arsimi, zbatueshmëria e rregullave ndërtimore (sipas planit urbanistik), prona publike dhe menaxhimi i saj, ambienti dhe menaxhimi i mbeturinave

Këtu do të duhej të inkorporoheshin të gjithë qytetarët, por pushteti është ai që vë rregullat. Andaj, paraprakisht me fushatë sensibilizimi, vënie të gjobave, vendosje të kontejnerëve dhe monitorim të tyre të vazhdueshëm, besoj se gjendja do të ishte e ndryshme nga e tanishmja.

- Infrastruktura, - Ndërtimi i rrugëve, - Projektet kapitale, - Decentralizimi i pushtetit qendror nëpër zona të qytetit. Këtu e vë theksin në Bashkësitë lokale ekzistuese. Duke pasur parasysh se dhënia e dokumenteve nuk është përgjegjësi e tërësishme e komunës, mirëpo komuna do të duhej të krijonte bashkëpunimin me institucionin që lëshon dokumentet në objektin komunal, që të bëhej decentralizimi nëpër bashkësitë lokale dhe të evitoheshin pritjet e gjata dhe burokracia e tepruar në objektin qendror komunal.

Kjo gjithsesi shkakton bezdi tek qytetarët dhe prishë imazhin e qytetit konkretisht udhëheqësve të saj.

- Përkrahja sociale
- Kujdesi ndaj Familjeve të dëshmorëve,
- Kujdesi ndaj pensionistëve,
- Kujdesi ndaj personave me aftësi të kufizuara,
- Transporti
- Shenjzimi i trafikut
- Parkingjet (sfidë kjo për kryeqytetin)
- Mbrojtja e trashëgimisë kulturore,
- Kujdesi ndaj rinisë.

Pjesëmarrja e qytetarëve në vendim-marrje

Pjesëmarrja e qytetarëve në vendim – marrje është sfidë për udhëheqjen komunale, ngase ekzistojnë vështirësi në urëlidhjen mes pushtetit dhe qytetarëve.

Gjithsesi mendoj se ndërlihdja e tyre do të ishte e favorshme për zhvillimet në qytetin përkatës.

Mendoj se format e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendim marrje kategorizohen në:

Pjesëmarrjen direkte që nënkupton daljen e qytetarëve në votim (apo referendum) për një çështje të caktuar me rëndësi të madhe për qytetin, dhe Pjesëmarrjen në vendime përmes këshilltarëve komunal të zgjedhur nga vetë qytetarët. Poashtu, diskutimet publike mbi çështjet madhore që janë pjesë e një qyteti, gjithsesi mendoj se duhet të merret edhe mendimi i qytetarëve, sepse bashkimi i ideve nga qytetarët të thjeshtë të cilët në vazhdimësinë ditore përballen me ato vështirësi, do ishte më efikas dhe frytdhënës. Andaj në këtë pikë mendoj se qytetari mund të jap ide dhe opinione, dhe në formë të këtyllë ai bëhet pjesë indirekte e proceseve dhe pjesëmarrjes së tij në vendim marrje. Aktualisht pjesëmarrja e tyre nuk është e kënaqshme, ngase edhe nëse realizohet ndonjë debat publik mungon mënyra e duhur e informimit dhe propagandimit. Faktori esencial pozitiv i mendimeve të qytetarëve është sepse çdo ditë ata prekin problematikat e qytetit të tyre, dhe praktikat e kanë demonstruar, se të qenit jashtë funksionit politik apo udhëheqës të bënë të mendosh ndryshe dhe kjo sjell pozitivitet në marrjen e vendimeve.

4

DRITAN SHALA - "Sikur të isha kryetar komune"**Roli i lidershipit në komunën time**

Kjo ese trajton me një gjuhë të thjeshtë nocionet lidership, menaxhment, administratë shërbyese dhe ndërlihdshmerinë e tyre me lokalitetin në komunën time. Në këtë linjë, ajo trajton konceptet vizion, politikë, strategji, plan veprimi dhe pjesëmarrje publiku. Në vazhdim, eseja eksploron rolin dhe rëndësinë e bashkëpunimit të liderëve të shoqërisë për zhvillim të gjithmbarshëm të komunitetit lokal/komunës dhe përmbillet me një listë rekomandimesh.

Shpesh ndodh të dëgjojmë nocionet "leadership" dhe "menaxhment" të përdoren si sinonime të njëra tjetrës. Gjithsesi, ato janë të ndryshme, ani se kanë veçori të përbashkëta. Leadership do të thotë udhëheqje dhe përfaqësim i një grupi, komuniteti, organizate a shteti. Karakteristikë e përgjithshme e një lideri, femër a mashkull, është aftësia për të projektuar të ardhmen duke u bazuar në rrethanat, njohuritë, shkathtësitë dhe eksperiencën, e para së gjithash vizionin e saj/tij. Pritet që një lider/e të mirë prezantoj zërin dhe interesat e atyre që e ndjekin e i besojnë, të jetë në gjendje t'i dëgjoj ata, influencoj, dhe t'i udhëheq ata e së bashku të udhëtojnë drejt vizionit dhe vlerave të përbashkëta. Ndërsa një lider i mirë krijon diçka, një menaxher apo koordinator i mirë mban dhe tejçon atë që është arritur. Në metaforë, "menaxheri është si qeni që shkon pas litarit të të zotit". Po qëlloi edhe qeni (menaxheri) i mirë sikurse dhe i zoti, e ka të lehtë, ndonëse jo pa sfida në veprimin e tij koordinues të punonjësve administrativ, prodhues a shërbyes si dhe koordinimin e proceseve të shërbimit, prodhimit, dhe rregullimin e funksionimit të brendshëm të organizatës - institucionit. Ndërsa fjala "administratë" do të thotë impenjim i përditshëm i një kategorie punonjësish në detajizim dhe realizim në praktikë atë që ka krijuar lidershipi dhe menaxhmenti, duke e përkthyer kështu në shërbim efikas e eficient qytetarit – komunitetit duke përmbushur kështu objektivat e përcaktuara nga një lidership vizionar të përkthyer në politika dhe strategji nga një menaxhment i mirë përgatitur.

Tani, le ti konkretizojmë pak koncepte abstrakte si "vizioni" nga i cili burojnë të tjera si "politika", "strategjia", "plani" për nga natyra me konkrete që gjithsesi iu dedikohen komunitetit dhe janë reflektim i mendimeve, nevojave dhe synimeve të tyre realizuar nëpërmjet pjesëmarrjes direkt të individëve – komunitetit dhe përfaqësuesve të tyre. Vizioni është një pikë në horizont, një gjendje që synohet të arrihet, e vlerësuar si ideale ndonëse gati asnjëherë arritshme, por gjithnjë e synuar të arrihet nëpërmjet planifikimit dhe punës së vazhdueshme. Dallojmë vizionin e një lideri dhe atë të komunitetit që idealisht pritet të jenë të unifikuar.

Në përmbushje të vizionit, në bashkëpunim me lidershipin, menaxhmenti ka rëndësi të lartë në përcaktimin e objektivave që për nga natyra janë më specifike se qëllimi e vizioni, ato duhet të jenë reale, të matshme dhe të arritshme brenda një kohe të paraparë. Objektivat që në vetvete tregojnë synim për të ndryshuar gjendjen nga një nivel momental në një më të lartë, p.sh. "rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve të Komunës së Pejës nga 30 në 70 % brenda një viti". Për çdo objektivë do duhej hartuar një plan veprues mbështetur në një strategji dhe politikë zhvillimore komunale.

Dallojmë politika sektoriale dhe ndër-sektoriale. Qasja ndër-sektoriale arrin kualitete më të larta edhe pse mund të jetë proces më i gjatë e kompleks, por ia vlen investimi në kohë, konsensus e mjete, pra "ia vlen barra qiranë" pasi që japin orientim më të drejt proceseve prosperuese të cilat zbërthehen tutje në një apo numër strategjish sektoriale si rrjedhojë më të qëndrueshme të cilat në vetvete tregojnë mënyrën e arritjes së objektivave dhe vizionit të komunitetit.

Në këtë proces thjeshtësimi, planet vepruese lokale janë dokumente në të cilat identifikohen veprimet specifike, treguesit e realizimit dhe ndikimit, mjetet njerëzore dhe monetare, bartësit dhe partnerët si dhe afatin kohor për realizimin e tyre. Realizimi i planit duhet të monitorohet dhe vlerësohet vazhdimisht nga një mekanizëm i krijuar paraprakisht, si nga vetë bartësit e këtyre planeve (autoritet lokale , shoqëria civile, biznesi), ashtu edhe nga grupet e interesit, përfshi pozitën dhe opozitën politike. Për më tepër, institucionet e pavarura të specializuara kërkimore e vlerësuese, vendore dhe ndërkombëtare, përfshi këtu edhe vlerësimin “krahases miqësor” komuna komunës brenda vendi apo edhe me ndonjë jashtë vendi nëpërmjet binjakëzimeve me komuna me karakteristika ngjashme. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka rëndësi të veçantë në mbledhjen, përpunimin dhe ofrimin e informatave statistikore të domosdoshme për hartimin e politikave zhvillimore, për të përcaktuar nivelin “zero” apo pikënisjen. Përdorimi i statistikave mundëson krahasimin e suksesit me vetveten, me komunat tjera, me objektivat apo treguesit kombëtarë si dhe për krahasim me komuna jashtë vendi.

Tani të hedhim pak dritë rreth rëndësisë dhe mënyrave të përfshirjes dhe bashkëpunimit të palëve të interesit përmendur më lartë. Nevoja e bashkëpunimit dhe shkëmbimeve ndër-sektoriale tashmë është e evidente. Për të arritur këtë, nevojiten mekanizma bashkëpunimi dhe koordinim ndër-sektorial dhe ndër-institucional. Bashkëpunimi ndër-sektorial nënkupton fillimisht veprim i bashkërenduar i sektorëve – departamenteve brenda një komune si dhe përfshirja, përmes forumeve e grupeve tematike punuese, e përfaqësuesve të shoqërisë civile, biznesit, ekspertëve duke mundësuar e inkurajuar pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të komunitetit të gjerë përmes konsultimeve dhe dëgjimeve publike gjatë gjithë procesit planifikues, elaboruar këtu, si dhe në vendimmarrje duke influencuar atë dhe për t’u informuar sidomos për gjërat që kanë të bëjnë me ta, përfshirë këtu grupet e marginalizuara ku interesi i tyre duhet marrë në konsiderim të veçantë që nga krijimi i vizionit të komunitetit, planifikimi dhe ndryshimet.

Bazuar në gjendjen momentale në përgjithësi e me theks të veçantë në Komunën e Pejës, ASRD rekomandon këto veprime praktike të përdorshme për të gjithë, siç vijon:

Komuna duhet te promovoj dhe përmirësoj marrëdhëniet me publikun përmes organizimit të:

- takimeve informuese dhe raportuese për punën e Komunës;
- dëgjimeve publike për Draft Legjislacionin e çështje tjera që ndikojnë jetën e qytetarit;
- tryezave me qytetar për priorizimin e projekteve bazuar në nevojat/kërkesat e tyre.

Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve për qytetarët do të mund të kultivohej nëpërmjet:

- komunikimin e vazhdueshëm me qytetarin sipas parimit “klienti në qendër”
- lehtësimin të qasjes në shërbime (qendrat pritëse, për shërbime të qytetarëve, etj.).
- hapja e zyrave të ish-bashkësive lokale e të tjera sipas nevojë për të qenë më afër tyre, dhe
- inkurajimi dhe mbështetja e strukturave përfaqësuese të lagjeve dhe fshatrave si “plaku i lagjes/fshatit” (burrë apo grua) etj., në baza tërësisht apolitike për të ndërlidhë bazën e gjerë të komunitetit me autoritetet lokale, për t’i artikulluar e përfaqësuar interesat e tyre dhe të shërbejnë si pika fokusi/kontakti e informacioni për të gjithë të interesuarit.

Përfshirja dhe kultivimi i marrëdhënieve në mes të Qeverisë dhe “hisnikëve” tjerë ne Qeverisje të mirë që me qëllim të ngritjes së imazhit të Komunës dhe komunitetit.

Së fundi, por njëlloj e rëndësishme është përdorimi i medias si aleat i fortë i komunitetit si duke i ftuar ata në konferenca shtypi e pajisur ata me komunikata e informacion relevant si dhe të inkurajohen që ato të bëjnë pune të pavarur kërkimore dhe informuese në shërbim të komunitetit.

5

MALIQ MALIQI - " Sikur të isha kryetar komune"

Roli i lidershipit

Roli i lidershipit mund të definohet si aftësi e individit për të ndikuar te njerëzit e tjerë ashtu që ata të bashkëpunojnë dhe të kontribuojnë për përpjekjet e orientuara për realizimin e qëllimeve të caktuara.

Udhëheqësi efikas bëhet atëherë kur perceptimi i udhëheqësit mbi autoritetin e vet është i ngjashëm me perceptimin e të tjerëve mbi autoritetin e udhëheqësit.

Duke u mbështetur në kuptimin se udhëheqja është aftësi e personit për të ndikuar në të tjerët ashtu që ata të bashkëpunojnë në kërkesën për të realizuar qëllimet e përbashkëta, del se udhëheqja është pjesë integrale e menaxhmentit.

Autoriteti i lidershipit mund të jetë: zyrtar dhe jozyrtar. Autoriteti zyrtar lidhet me pozitën dhe jo me personelin, sepse personeli duhet kuptuar dhe vrojtuar si bartës i përkohshëm i funksionit apo gradës. Thënë shkurt autoriteti zyrtar është pozitë dhe jo person.

Autoriteti jozyrtar apo joformal paraqet në esence autoritetin personal apo "karizmatik". Ky lloj autoriteti nuk ka bazë apo burim zyrtar që del nga pozita apo funksioni por paraqet në fakt lidershipin e vërtetë. Lidershipi i tillë këtë e realizon në shumicën e rasteve me fenomenin e "tërheqjes, "magnetizimit" apo komponenteve tjera që burojnë nga kompleksiteti i personit e jo nga pozita. Karizma në fakt paraqet vetitë e lidershipit i cili posedon cilësi të atilla që krijojnë mundësi për lojalitet, besueshmëri dhe entuziazëm për ata që e përcjellin. Të rrallë janë personat që posedojnë aftësi të mëdha tërheqëse, magnetike si rezultat i personalitetit dhe kompaktësisë personale njerëzore e jo si rezultat i titullit, pozitës apo gradës.

Cilësi e mirë ndaj shërbimeve për qytetarët

Masat për arritjen e një cilësie të mirë janë:

- Organizimi efektiv i drejtorisë lokale në rend të parë potencialeve njerëzore dhe shkallës së përgjegjësisë së secilit të punësuar në organet lokale;
- Themelimi i agjencionit lokal për zhvillim me shërbim të posaçëm për zhvillimin e bujqësisë;
- Të forcohet roli i bashkësive lokale duke motivuar punën e organit përgjegjës me qëllim të përfshirjes më aktive të secilit qytetar në procesin e vendimmarrjes;
- Me instrumente të bashkëpunimit të arrihet jetë e balancuar politike e qytetarëve në territorin e Komunës me vetëdijesim të elementeve të interesit të përbashkët dhe krijimi i sinergjisë së interesit për të mirën e përbashkët;
- Të zhvillohet një strategji e qartë dhe reale e zhvillimit të sektorit të biznesit dhe sektorit joqeveritar duke definuar rolin e udhëheqjes lokale në këtë proces;
- Të definohet qartë strategjia e "marrëdhënive të jashtme" dhe të delegohet autoriteti që ka të bëjë trajtimin e sektorëve:
- edukimi: përcjellja dhe arritja e suksesit
- diaspora
- sektori ekonomik: ekonomia, investimet dhe kursimet
- bashkëpunimi me komunat përreth, bashkëpunimi me interes me komunat e tjera.

Për arritjen e masave të përmendura, hapi i parë është gjithësesi politika thelbësore e kuadrove e cila do të bazohet në metodat udhëheqëse me resurset humane. Ky bashkëpunim me potencialin

intelektual dhe me përvojë duhet të ndërtohet në bazë të besimit dhe përgjegjësisë absolute në përputhje me principet demokratike.

Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje

- Sigurimi i pjesëmarrjes funksionale të qytetarëve në marrjen e vendimeve në nivelin lokal me forcimin e statusit të bashkësive lokale dhe vendosjen e strukturës profesionale përmes rolit të kryetarit të bashkësisë lokale
- Të punohet në mënyrë aktive në planifikimin e projekteve në të gjitha segmentet e zhvillimit të komunës, të sigurohen elementet e monitorimit dhe të informacionit.
- Plotësisht të çrrënjosen shkaktarët e korrupsionit dhe të pamundësohen veprimet e tilla të mëtejme.
- Të bëhet revizioni i planit strategjik të zhvillimit të komunës dhe të bazohet në qëllime të arritshme dhe reale si dhe të gjitha kapacitetet e komunës t'i përkushtohen realizimit të atyre qëllimeve.
- Të sigurohet një marrëdhënie me përgjegjësi e organeve gjegjëse qeveritare me qytetarët.
- Aktivisht të punohet në stabilizimin e marrëdhënieve ndërnacionale në territorin e komunës.
- Të punohet në mënyrë permanente në rritjen e buxhetit të komunës.

Bashkëpunimi me prodhuesit bujqësorë

Është më se i nevojshëm themelimi i një agjensioni për zhvillim lokal si qendër e shërbimeve për bujqësi, e cila në mënyrë dinamike do të punojë në zhvillimin e përsheptuar të të gjithë sektorëve bujqësorë, bazuar në kapacitetet njerëzore dhe natyrore të komunës.

- Të zhvillohet një strategji e qartë e zhvillimit të bujqësisë dhe të shfrytëzohen të gjitha potencialet në arritjen e qëllimeve strategjike në këtë fushë.
- Në përputhje me planin e zhvillimit, me ekipin për zhvillim, shoqatat, bujqit etj. në bazë të dokumentacionit të projekteve serioze të sigurohen fonde të ndryshme me financim afatgjatë (kreditë dhe grante) për fillimin apo zgjerimin e prodhimit.
- Të mundësohet edukimi i përhershëm dhe informimi i plotë i prodhuesve bujqësorë.

Puna me agjensionet turistike

- Themelimi i zyrës lokale turistike me një plan të qartë të zhvillimit dhe promocionit.
- Të bëhet evidentimi i resurseve turistike ekzistuese dhe kapaciteteve tjera të komunës.

Puna me të rinjtë

Të vendoset një mekanizëm për komunikim me të rinjtë dhe të përkrahet organizimi i të rinjve nëpër organizata joqeveritare.

6

RREZEARTA REKA – “ Sikur të isha kryetare komune”**Pjesëmarrja qytetare në vendim-marrje**

Fuqizimi i komuniteteve lokale, si mekanizëm i qëndrueshëm i pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje.

Hyrje

Pjesëmarrja e qytetarëve në vendim-marrje konsiderohet me të drejtë si një e “mirë kolektive” (Dunn, 2000, fq. 245). Prandaj, implementimi i politikave që kanë për qëllim mundësimin, nxitjen dhe realizimin praktik dhe jo vetëm formal të kësaj pjesëmarrjeje është një proces politik që pa dyshim kërkon përkushtim të madh në planifikim dhe hartim të strategjive implementuese.

Kur flasim për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendim-marrje, duhet të kemi parasysh vazhdimisht dallimin midis pjesëmarrjes pozitive dhe asaj negative. Pjesëmarrja negative si koncept dhe mekanizëm i qytetarëve për të ndikuar në politikat e nivelit qendror dhe atë lokal nuk është i panjohur për qytetarët e Kosovës. Kjo pjesëmarrje negative është shprehur në forma si protesta, demonstrime të pakënaqësive, greva dhe tubime të qytetarëve. Kjo si pasojë e paqartësisë ligjore (me ekzistimin e vëllimit të pafund të rregulloreve, udhëzimeve, statuteve, etj. që garantojnë pjesëmarrjen e qytetarëve në vendim-marrje), mungesës së traditës demokratike (regjimi i gjatë komunist, administrata tejet burokratike dhe mbi të gjitha diskriminuese ndaj grupeve të caktuara etnike), edukimi joadekuat mbi format e pjesëmarrjes qytetare. Prandaj, ekziston nevojë eminente për të adoptuar një mekanizëm të mirëfilltë të pjesëmarrjes pozitive të qytetarëve në vendim-marrje, përmes fuqizimit të komuniteteve lokale e që do të shërbente si mekanizëm i qëndrueshëm përmes të cilit më pas do të mund të intervenohej edhe në përmirësimin e shërbimeve drejt qytetarëve, në forcimin e rolit të lidershit për qytetarët dhe marrjes së vendimeve të përbashkëta e me rëndësi për të gjithë.

Prandaj, më poshtë rekomandohet një veprim që do të kombinonte strukturën në vijim:

Alternativa e rekomanduar

Veprimi zhvillimor dhe fuqizimi i komuniteteve në nivel lokal

Implementimi i alternativës së rekomanduar do të duhej të kishte për fokus një pilot-komunë dhe një pilot-lagje e cila ka bazë për të akomoduar implementimin. Qëllimi i kësaj alternative është të bashkojë një kornizë të qëndrueshme ligjore me një mekanizëm praktik, për të ngritur pjesëmarrjen dhe përfshirjen e qytetarëve në vendim-marrje, nisur nga koncepti kryesor, që pjesëmarrja është një e mirë kolektive. Një kornizë e tillë ligjore do të duhej të ishte praktike, e qartë, përfshirëve, koncize dhe e lehtë për t'u kuptuar dhe implementuar. Brenda kësaj kornize më pas, dispozita të caktuara do të duhej të garantonin themelimin e strukturave të reja, si Komisioni për Fuqizimin e Komuniteteve dhe Bordet Lokale të Komuniteteve (ngjashëm me Bashkësitë Lokale por duke ju dhënë akoma më shumë kompetenca dhe resurse për të funksionuar), që do të funksiononin nëpër lagje. Kjo do të siguronte afrimin edhe më të ngushtë jo vetëm me qytetarët në përgjithësi, por me një komunitet të caktuar, me specifika, nevoja dhe kërkesa të caktuara qartë. Po e njëjta kornizë ligjore do të duhej të parashikonte edhe ndarjen buxhetore të komunës për Bordet Lokale. Pas miratimit të kësaj kornize, do të duhej të fillonte procesi i trajnimit për themelimin e Bordeve Lokale të Komuniteteve (apo Bashkësive), bazuar në “praktikat e mençura” (Osborne dhe Plastrik, 2000, fq. 487-489). Veprimi zhvillimor do të duhej të ndërthente një grup veprimesh të ndërmarrë nga Ministria e Vetë-Qeverisjes Lokale, që do të siguronte mjetet e duhura të motivimit, si mbështetjen për komunat të cilat inkurajojnë pjesëmarrjen e qytetarëve në vendim-marrje.

Ideja për fuqizimin e komuniteteve buron nga mentaliteti i qytetarëve për t'u organizuar në “pleqëri” në mënyrë që të merrret një vendim i rëndësishëm për tërë komunitetin. Komunitetet në nivel

lokal do të organizoheshin përmes Bordeve të Komuniteteve që do të kryesoheshin nga anëtarë të respektuar të Komunitetit dhe nga një anëtar që do të emërohej nga Autoritetet Komunale. Këto Borde do të funksiononin përmes buxhetit të ndarë komunal por pse jo edhe nga donacionet e agjencive të ndryshme, iniciativave mbështetëse dhe bizneseve private. Roli i këtyre Bordeve do të ishte të ngritej vetiniciativa, inkurajimi i projekteve për çështje të komuniteteve dhe normalisht të pakësohej ngarkesa e autoriteteve komunale për ofrimin e shërbimeve eficiente.

Kostoja:

Shpenzimet për edukim dhe aktivitete lobuese; procesi i hartimit të politikës adekuate; krijimi i strukturave të reja; fondet për trajnim; fondet për Bordet e Komuniteteve në nivel lokal (zyra, stafi, materiali shpenzues, etj.); shpenzimet për hulumtim para dhe pas implementimit të kësaj alternative (monitorimi, etj.); fondet për programet përfshirëse; shpërblimet për Komunat (si: Komuna e Vitit, Prefekti i Vitit, Komuniteti më me ndikim); shpenzimet për dukshmërinë e iniciativës (fushata mediale periodike, që do të shërbenin edhe si motivim shtesë për komunitetet e tjera në rajone të tjera).

Efektiviteti:

Edukimi i suksesshëm dhe lobimi; hartimi dhe miratimi i politikës për fuqizimin e komuniteteve të nivelit lokal; themelimi i Komisionit për Fuqizimin e Komuniteteve dhe themelimi i Bordeve Lokale të Komuniteteve; hulumtimi; efektivitet më i madh dhe i qëndrueshëm.

Partnerët implementues dhe palët e interesuara:

Komuniteteve dhe qytetarët në përgjithësi;
Komunat e Kosovës në përgjithësi dhe në veçanti Pilot - Komuna;
Pilot - lagja e caktuar ku do të implementohej Bordi Lokal i Komunitetit;
Ministria e Vetë-Qeverisjes Lokale;
Ministria e Financave;
Parlamenti;
Institucionet ndërkombëtare, OJQ-të, donatorët;
Bizneset Private.

Qëllimet:

Miratimi i një kornize të uniformuar mbi fuqizimin e komuniteteve në nivel lokal;
Ngritja e nivelit të pjesëmarrjes së qytetarëve në vendim-marrje;
Adoptimi i pjesëmarrjes pozitive në vend të asaj negative;
Afrimi i qeverisë lokale më pranë qytetarëve;
Arritja e transparencës dhe përgjegjshmërisë në qeverinë lokale ndaj qytetarëve;
Ngritja e nivelit të kënaqshmërisë së qytetarëve me shërbimet komunale;
Koordinimi midis partnerëve implementues dhe palëve të interesuara.
Pra, alternative e rekomanduar do të kombinonte bazën ligjore, që do të lejonte pjesëmarrjen e qytetarëve në vendim-marrje, të kuptueshme për të gjithë, përmes krijimit të Bordeve lokale, në lagje të caktuara. Kjo meqë, vetëm banorët e lagjes specifike do të dinin më së miri prioritetet, mangësitë dhe nevojat e lagjes në fjalë, qoftë kjo sanimi i një rruge, mbledhja e mbeturinave, një vend lojërash për fëmijët e lagjes, etj.

7

SKENDER LUTFIU – “ Sikur të isha kryetar komune”

Po të bëhesha i pari i komunës së Ferizajt në një mandat dy vjeçar , unë do të bëja që është e mundur që qyteti i Ferizajt të marrë një fizionomi krejt më ndryshe. Duke pasur parasysh problemet me të cilat ballafaqohen qytetarët e saj , dhe duke u bazuar në të ardhurat dhe buxhetin e komunës do të mundohesha që në mënyrë sa më racionale parat e taksapaguesve t'i shfrytëzoj në projekte të ndryshme kapitale që do të ndikojnë direkt në jetën e qytetarëve të kësaj komune.

Hapi i pare që do të bëja do të ishte fillimi i një pune duke u bazuar në disa parime universale siç janë: sundimi i ligjit, përgjegjësia, transparenca, lufta kundër korrupsionit, respektimi i parasë publike, dhe mbi të gjitha respektimi i çdo qytetari , duke pasur parasysh që me votat e tyre e veçoj këtë post dhe kam obligim moral dhe qytetar që të jam në shërbim të qytetarëve në çdo kohë.

Si çdo qytet edhe Ferizaj ballafaqohet me një gamë të tërë problemesh , zgjidhja e të cilave donë një punë të madhe dhe një vullnet të hekurt , kur ke parasysh buxhetin modest në krahasim me kërkesat emergjente.

Ndër projektet kapitale që do të bëja gjatë mandatit dy vjeçar do të jenë:

- Zgjidhja e problemit të hekurudhës;
- Investimi në infrastrukturë (në rrugë, kanalizim, ujësjellës etj);
- Stimulimi në investime të ndryshme në biznese të vogla dhe të mesme;
- Investimi në objekte të ndryshme kulturor-arsimore (ndërtimi i objektit të teatrit të qytetit dhe ndërtimi i një objekti modern për muzeun e qytetit);
- Investimi në bujqësi;
- Përkujdesje dhe trajtim i veçantë për invalidët e luftës, familjet e dëshmorëve dhe pensionistët, duke mos harruar këtu edhe shtresat e tjera të shoqërisë;

Për zgjidhjen e problemit të hekurudhës që ndan qytetin në dysh dhe paraqet vështirësi në komunikacion dhe rrezik permanent për kalimtarët (disa qytetarë kanë gjetur vdekjen), mendoj se zgjidhja e tij mund të jete largimi nga qyteti i binareve dhe vendosja e tyre jashtë qytetit. Por në pamundësi për t'i hequr binaret nga qyteti, atëherë duhet urgjentisht që të vendosen nënkalime në shume pika ku janë të frekuentuara nga qytetarët.

Si prioritet në mandatin tim do të jetë edhe investimi në infrastrukturën rrugore për arsye se duke pasur parasysh numrin e banorëve dhe rritjen e shpejtë të qytetit sidomos pas luftës, dhe problemet me komunikacion si rezultat i trafikut të dendur mendoj se do ishte pune me vlerë rregullimi dhe zgjerimi i rrugëve në qytet konkretisht rruga “Ahmet Kaçiku” të bëhet më dy krosi dhe gjithashtu rrugët në hyrje të qytetit nga drejtimi i Prizrenit, Prishtinës dhe Gjilanit , zgjerimi i të cilave do të liroj komunikacionin në masën më të madhe dhe do të liroj qarkullimin më të lirë të qytetarëve. Pastaj ndërtimi i rrugëve të reja me standarde ndërkombëtare duke përfshirë këtu gjerësinë 9 metra, pastaj trotuaret për këmbësorët, ndriçimin e rrugëve etj. Në rrugët ekzistuese do të rregulloja trotuaret ngase janë në gjendje të mjerueshme si rezultat i punimeve të ndryshme që janë bërë gjatë viteve të fundit në qytet. Këtu do të shtoja edhe punimet që do ti kryeja në rregullimin e ujësjellësit aty ku nuk ka rrjetë në të gjitha lagjet e qytetit.

Po ashtu edhe rritjet të kanalizimit do t'i kushtoja një rëndësi të veçantë jo vetëm në qytet por edhe në të gjitha fshatrat e Komunës së Ferizajt.

Sa i përket pikës së tretë do të mundohem që të ulë taksat për bizneset e vogla dhe të mesme si masë për stimulim dhe do të krijojme infrastrukturë dhe lehtësira të tjera për një veprimtari sa më të suksesshme.

Për rëndësinë e objekteve kulturo-arsimore nuk do të ndalem këtu ngase gjykoj se e dinë të gjithë qytetarët , por do shtoja se duke pasur parasysh që Ferizaj është ndër qytetet më të mëdha në Kosovë, mungesa e objektit të teatrit dhe krijimi i muzeut të qyteti është mese i nevojshëm, kur kemi parasysh traditën kulturore që ka ky qytet. Por projektet në këtë lëmi nuk do të përfundojnë vetëm me ndërtimin e këtyre dy objekteve, por do punohet edhe në objektet ekzistuese etj.

Bujqësia gjatë mandatit tim do të zë një vend kyç në projektet e mija , ngase është me rëndësi të jashtëzakonshme. Do të mundohemi që t'iu ndihmojmë të gjithë fermerëve me anë të investimeve në ndërtimin e minifabrikave për prodhimin e produkteve të qumështit, të cilat do të krijojnë vende të reja pune , pastaj investime në segmente të tjera që do të ndikojnë drejtpërdrejt në stimulimin e qytetarëve për tu marrë me bujqësi. Për këtë qëllim do të punonim në rregullimin e infrastrukturës rru-gore, në mënyrë që të mos ketë shpërngulje të mëdha të qytetarëve nga fshati në qytet, sepse kjo pas-taj sjell braktisjen e tokave të bukës dhe rritë numrin e të papunëve në qytete.

Një kujdes të veçantë pa dyshim që meritojnë invalidët e luftës dhe familjet e dëshmorëve sepse gjykoj se janë shtresa më e lënë pas dore pasluftës , ndërsa është dashur kujtoj unë që të kenë një tret-man të veçantë.

Këto, janë vetëm disa nga prioritetet tona që mendojmë se duhet zgjidhur gjatë mandatit që do të mbajë si kryetar i Ferizajt, sepse, neve kemi plane më të detajuara edhe për fusha të tjera si: Mjekësi , Kulturë, Arsim, etj.

8

VISAR KRASNIQI – “Sikur të isha Kryetar komune”

Me të fituar besimin e qytetarëve, puna e parë që më bije ndërmend është organizimi i një aksioni të madh për pastrimin e qytetit dhe heqjen e mbe-turinave. Mund t'i paramendoj vështirësitë, por punës do t'i kisha shkuar deri në fund. Si mbështetje gjatë punës sime, do të kisha ndërmarr një fushat lagje për lagje, duke biseduar me banorët për të ngritur vetëdijesimin për një ambient sa më të pastër. Ndoshta ky duhet të jetë vizion dhe strategjia e një lideri/kryetari, i cili do të fitonte besimin e qytetarëve të tij, mbase ky do të ishte edhe çelësi i suksesit për një qeverisje të suksesshme dhe efikase.

A është e thjeshtë të arrihet deri të suksesi? Mendoj se po. Qasja pragmatike ndaj secilit problem do të ma mundësonte këtë.

Duke u munduar që të heq nga mendja e çdo qytetari veprimet e jashtë ligjshme, ndërtime pa leje, uzurpimet e pronës, që degradojnë dhe shkatërrojnë një qytet, do të kisha nisur një tjetër projekt për të informuar të gjithë sesi duhet të kryejnë shërbimet në Komunë. Kurse nëpunësit do t'i inku-rajoja për një mobilizim dhe një sjelle në harmoni me rregulloret në fuqi.

Takimet përjavshme me banorë e qytetit që do të udhëhiqja, për mua do të ishin pjesa kryesore e punës sime. Vetëm duke dëgjuar hallet e qytetarëve, do të tregohesha i denjë në qeverisje, e jo një lider që i injoron problemet me të cilat ballafaqohen ata.

Gjithçka që lidhet me qytetarinë, si kryetar komune do të më kishte nxitur të reagoj në kohën e duhur, që në mënyrë të efektshme të zgjidh problemet. Do të kisha mirëpritur çdo informacion që ka lidhje luftimin e korrupsionit, që nuk shkon diçka me rregull kontratat nëpër ndërmarrje publike komunale, tenderët, infrastrukturë, zënien e pronën publike, lejet e ndërtimit, shërbimin e inspektoratit... ndërsa moto e punës do të ishte: Gjithçka transparente. Këtu mendoj gjithçka që në vete përmban seriozitet, suksesin do të jetë i garantuar.

Askush nuk do të ma kishte ndaluar që të kërkoja nga kompanitë e mirëmbajtjes t'i pastroj rrugët për çdo mbrëmje, të kujdesen për ndriçimin e rrugëve për çdo ditë; që secili nëpunës administrativ ta kryej punën që i takon. Po të jetë e nevojshme, përgjegjësit për çdo ditë do të kujdeseshin edhe për një dritë semafori. Për të gjitha këto, duhet vendosmëri, ide dhe kreativitet. Cilësia në shërbim nuk matet vetëm me financa, por me përkushtim. Serioziteti në punë do t'i bindte qytetarët për një të ardhme të sigurt evropiane. Kryetar Komune, nuk mjafton ta kesh vetëm emrin. Nuk mjafton të thuash nuk ka mjete. Një projekt i mirë, do të nxiste përkrahjen e banorëve, që janë korrektuesit me të saktë. Prandaj them se çdo komune i duhet një kryetar komune, që është i gatshëm të marrë vendime të guximshme, të përballet me sfida.

Lidhja e kontratës me qytetarin nuk do të thotë zgjidhje e problemit. Bash, këtu fillon puna, sfida për të arsyetuar votën e dhënë, për të cilin duhet të japësh përgjegjësi. Komunës nuk i duhet një kryetar burokrat, por një kryetar i cili di të marr vendime, qofshin ato të rënda, në momente të caktuara. Që di t'i sfidoj edhe ata që nuk ia duan të mirën qytetin. Siç e thash edhe me lartë, bashkëbisedimi i vazhdueshëm dhe lejimi i pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje do të më jepnin mundësin që t'i merrja më lehtë të gjitha vendimet. Njohja me realitetin, i jep frytet e veta. Ndërsa, bashkëpunimi i ngushtë me shoqërinë civile, mediat, të më siguronin lehtësi në zgjidhjen e problemeve.

Krejt në fund them se është koha të kemi një kryetar komune, që di të komunikoj me të gjithë. Është koha për një njeri që i jep kuptim emrit Kryetar.

9

GANI ISMAJLI – “Sikur të isha Kryetar Komune”

Roli i Lidershipit

Posti i Kryetarit të komunës është pozicion qendror, vendimmarrës që në mbështetje të Kuvendit Komunal dhe drejtorëve komunal në kabinetin të tij, vendos për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me komunën në përgjithësi, duke u bazuar në ligjet në fuqi.

Vizioni – do të kemi institucione efikase komunale në shërbim të zbatimit të politikave në interes të funksionimit dhe zhvillimit komod të jetës së qytetarit, në tërë hapësirën administrative të komunës.

Misioni – implementimi i programeve zhvillimore në interes të qytetarit dhe bashkësisë, me qëllim të zhvillimit normal të jetës, në perspektivë të ngritjes së mirëqenies për ta, në gjithë hapësirën administrative të komunës.

Aktivitetet

Analiza e gjendjes ekzistuese që ka të bëjnë me efikasitetin e zbatimit të programeve të parapara për të gjitha shërbimet që mbulojnë drejtoratet e komunës,

Harmonizimi i veprimeve në pajtim me vendimet legjislative që merren në kuvendin e Komunës, apo në instanca qendrore,

Të ngarkohen drejtoratet që brenda periudhës së caktuar kohore në të gjitha nivelet të bëhet ndarja e përgjegjësi (përshkrimi i vendeve të punës) për personelin e angazhuar,

Marrja e opinionëve nga strukturat e ndryshme organizative si BL, komunitete, përfaqësues të subjekteve ekonomike, bamirëse etj, për konstatimin e gjendjes ekzistuese dhe për nevojat për intervenim përmes shërbimeve komunale, apo për bashkëveprim në realizimin e projekteve konkrete, Në bashkëpunim me drejtorët komunal, nën menaxhimin e drejtoratit për buxhet dhe financa përgatitën propozimet për buxhet,

Harmonizimi i planeve të veprimit me komunat tjera të regjionit dhe atyre në nivel vendi,

Përfaqësimi i interesave të Komunës në raport me institucionet qendrore të vendit,

Përfaqësimi i interesit të komunës për bashkëpunim në nivel ndërkombëtar me institucione të niveleve dhe fushave të ndryshme (bashkiake, qeveritare etj),

Ngritja e nivelit profesional të administratës komunale, shërbimeve të inspektorateve, me qëllim të ngritjes së efikasitetit,

Mbikëqyrja e hartimit detal të projekteve dhe kategorizimi i tyre në prioritete, gjithashtu për secilin projekt kërkohet të bëhet plani i veprimit,

Bashkëpunimi me nivelin qendrorë si me MPL, dhe ministritë tjera për bashkëveprim në implementimin e projekteve në sfera të ndryshme dhe ngritja e komisioneve për ndarjen e detyrave në mes subjekteve dhe përcjelljen e ecurisë së implementimit të programit përkatës,

Prezantimi me kohë për opinion dhe për faktorët relevant të projekteve që komuna synon ti realizoj,

Hulumtimi i mundësive alternative të financimit të projekteve si; Donacione, bashkëfinancim, koncesione, huamarrje, apo forma tjerë që vlerësohen si efikase,

Përcjellja e efikasitetit të kryerjes së shërbimeve nga ana e kompanive publike, dhe atyre të kontrak-

tuara dhe marrja e masave për mos efikasitet eventuale të tyre,
Shërbimi i prokurimit në komunë të menaxhojë punët në mënyrë profesionale dhe shumë transparente,

Për procesin e rregullsisë së tenderimit të sigurohen informata kthyesë nga subjekte dhe individ që kanë njohuri për procedurat e tenderimit për punë konkrete,

Mbikëqyrja e komisioneve për inspektimin e implementimit të të gjitha fazave të projektit konkret dhe informimi përmes raportimit me kohë për të gjitha detajet mbi ecurinë e implementimit nga ana e organit që është i ngarkuar për përcjellje,

Marrja e masave për kontraktohet që nuk përmbushin obligimet ndaj kontratës,

Marrja e masave për funksionim në nivel të lartë dhe shumë transparent e shërbimeve të inspektorateve dhe ngritja e motivit të inspektorëve dhe personelit tjetër ekzekutues, varësisht nga shkalla e interesit të komunës dhe shkallës së rrezikshmërisë së kryerjes së punës,

Vlerësimi i personelit, komisioneve dhe njërive tjera në kuadër të KK të bëhet në bazë të efikasitetit të kryerjes së detyrave, bazuar në përgjegjësit që ka me përshkrim të punës.

Aktivitetet e lartcekura bëjnë që Kryetari i Komunës të ketë situatën në dorë në vazhdimësi dhe të merr masa për çështje të nevojshme me kohë dhe në harmoni me interesin e realizimit të programit konkret. Fitimi i besimit të qytetarëve për korrektësinë dhe aftësinë e organeve komunale për menaxhimin me mjete të cilat janë kontribut (taksa dhe tatime) i tyre do të ishte qëllimi kryesorë, por kjo do të arrihej me një bashkëpunim të ngushtë me qytetarin, lagjen, bashkësinë lokale, subjektet ekonomike dhe jo ekonomike që veprojnë në territorin e komunës, dhe subjekte tjerë. Opinioni do të njoftohet për aktivitetet që zhvillohen në komune, efikasitetin e zbatimit të planeve, synimet dhe metodat e realizimit të programeve konkrete, funksionimin e rrjetit të shërbimeve komunale, njoftimin me masat ndëshkuese për ata që shkelin ligjin (ndërtimet pa leje, moskryerja e obligimeve tatimore, uzurpimet etj) dhe alternativa e punës legale, stimulimin dhe forma tjera regresimi për veprimtarit me interes, bashkëpunimin me komunitet në identifikimin e parregullsisë eventuale gjatë zbatimit të projekteve apo shërbimeve të rregullta, (kjo do të realizohej me një bashkëpunim me të afërt me njerëz dhe subjekte të cilët mund të ofrojnë fakte për parregullsi gjatë kryerjes së ndonjë projekti apo shërbimi qoftë në infrastrukturë, kryerje të shërbimeve të inspektimit, për kompanitë e kontraktuar për punë përmes komunës, e për të gjitha shërbimet tjera komunale). Bashkëpunimi me qytetaret do ta shtoj efikasitetin e kryerjes së aktiviteteve me interes për ta, komuniteti do të jetë trup mbështetëse në të gjitha fazat e implementimit të programit konkret, shumë projekte do të zhvillohen në bashkëfinancim me komunitet dhe ata përmes përfaqësuesve të tyre do të jenë pjesë e mbikëqyrjes së realizimit të punës që është drejtpërdrejtë interes i tyre. Formë tjetër e komunikimit me qytetarë do të jetë posta elektronike ku do t'iu mundësohet qytetarëve të shprehin mendimet, kërkesat, vërejtjet për parregullsi të kryerjes së shërbimeve, etj. Gjithashtu është e domosdoshme organizimi i tribunave dhe formave tjera të takimit (herë-pas-herë) me qytetarë për të biseduar për çështjet që janë në interes të tyre.

Për implementimin e politikave të saja komuna duhet të lidh marrëveshje mirëkuptimi për bashkëpunim me Ministrin e Rendit, Transportit dhe Telekomunikacionit, Shëndetësisë, Arsimit, Punës dhe Mirëqenies, Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

10

ERALDIN FAZLIU - "Sikur të isha kryetar komune"

Të jemi të pushtetshëm, do të thotë të kemi aftësi për të ua imponuar të tjerëve gjërat që në realitet nuk do të i bënin. Ky është definicioni klasik mbi pushtetin dhe në këtë rast do të doja të kishim ndryshim konotacioni të definimit të pushtetit, sepse në botëkuptimin tim, pushteti nuk të jep të drejtën për të ua imponuar të tjerëve gjërat pa vullnetin e tyre, përkundrazi ardhja në pushtet duhet të jetë e koordinuar me vullnetin e qytetarëve dhe plotësisht në respektimin e përgjegjësive që ke marrë nga qytetarët.

Qasja ime liberale konsiston në besimin në vlerat dhe liritë individuale të njeriut, si të drejta të pakontestueshme.

Të qeverisësh një komunë, konsideroj se është një ndër privilegjet dhe nderet më të mëdha që keni pasur rastin të i keni, por edhe një përgjegjësi e lartë kundrejt atyre që kanë besuar në vlerat, bindjet dhe programin tuaj të proklamuar në fushatën zgjedhore.

Ardhja në pushtet me gjithë peripecitë mund të realizohet, por mbajtja e pushtetit në përputhje me atë çka keni proklamuar dhe zbatimi i politikave që do të ndikonin në rritjen e standardit jetësor dhe mirëqenies sociale të qytetarëve, mund të jetë një ndër sfidat më të mëdha që keni pasur rastin të i keni.

Në vazhdim do të i paraqes disa nga idetë dhe strategjitë që do të i aplikoja nëse do të ulesha në stolin e kryetarit të komunës sonë.

Hipotetikiqisht, po të bëhesha kryetar i komunës sonë, kisha për të caktuar një takim me stafin e ardhshëm, ku do kërkoja një angazhim të gjithmbarshëm për të i arritur qëllimet dhe objektivat e përbashkëta. Ky mund të jetë një prej shume indikacioneve të tjera se puna ekipore do të jetë prioritare, ngase neve mendoj jemi mësuar me një trend të udhëheqjes elitare, i cili stil është shumë i dëmshëm për shoqërinë në përgjithësi.

Do të vazhdoja të identifikoja problemet e qytetarëve të cilat nuk kërkojnë implikime të larta buxhetore, por që dukshëm mund të e ndryshojnë cilësinë e jetesës së qytetarëve, të cilat probleme, kërkojnë një shtytje dhe vullnet të gjithmbarshëm. Në vazhdim të kësaj politike do të e formoja një zyrë, e cila do të merrej me paraqitjen e efekteve negative të cilat e rëndojnë qytetin tonë të tillë si korrupsioni, nepotizmi, mostransparenca e zyrtarëve të komunës, depolitizimi, deburokratizimi etj. Në kuptim të rritjes së transparencës, administrata publike është një resor, ku do të kërkoja ndërrim të qasjeje, duke krijuar lehtësira administrative dhe duke i ikur burokratizimit të panevojshëm. Duke e ditur se qyteti ynë ka një diasporë aq masive, do të themeloja një zyrë stinore, e cila do të shërbente si kapacitet shtesë për të iu krijuar mundësi që diaspora jonë të ketë përkujdesje më intensive nga administrata jonë për nxjerrjen e dokumenteve të nevojshme. Këto lehtësira, që nuk kërkojnë implikime të larta buxhetore dhe shtojnë kredibilitetin e qytetarëve tonë në administratën apo në udhëheqjen tonë. Nëse do të bëhesha kryetar i komunës sonë, do të e caktoja një nga ditët e javës që të takohesha me qytetarët për të i dëgjuar brengat dhe shqetësimet e tyre, njëherit duke kërkuar zgjidhje alternative për shqetësimet e tyre. Ky do të ishte një rast i mirë për të qenë sa më afër qytetarëve tonë, duke iu dhënë atyre mesazh ndjeshmërie reciproke për problemet e tyre.

Në kuadër të procesit të vendimmarrjes, në shumicën e komunave të Kosovës, kemi një deficit të participimit të qytetarëve në këtë aspekt, dhe citimi i Frederikut të Madh më së shumti i përgjigjet

gjendjes se vendimmarrjes: "Populli im mund të thotë çka të dojë, por unë mund të bëjë çka të dua", prandaj në këtë kontekst do të doja që në prag të marrjes së vendimeve kryesore për qytetin tonë, të kemi debate të hapura dhe nga këto debate mund të nxirren sugjerime dhe rekomandime të ndryshme dhe nëse janë racionale të hyjnë në vendimet, dhe jo këto takime të mbeten si formale dhe vendimet të merren nga një grup vicioz i njerëzve. Vendimmarrja është një ndër segmentet kryesore në konglomeratin e elementeve të demokracisë, prandaj avancimi i pjesëmarrjes së qytetarëve në këtë proces do të ishte crucial.

Depolitizimi është një projekt tjetër, ku me tërë energjinë do të angazhohesha, pikënisje do të ishte një kërkesë që qytetarët të paraqesin çdo rast, kur ata për arsye të politizimit të ndonjë procesi janë anashkaluar. Diskriminimi i tillë do të ishte absolutisht i papranueshëm në menaxhmentin tonë. Në kuadër të zhvillimit të marrëdhënieve me mediumet, konsideroj se duhet të kemi një rikonsolidim dhe të kemi një qasje më të hapur në raport me mediat, duke i lejuar atyre një informim sa më jo të influencuar dhe të pavarur. Shpesh ndodh që mediumet të janë vegla të pushtetit, dhe pavarësia editoriale pastaj humbet, duke aluduar në informim jo të pavarur.

Qyteti ynë nga pamja e jashtme, duket të jetë shumë i bukur, pasi pamja e Lubotinit dhe maleve Sharr e vë në një pozitë shumë të mirë gjeografike, por gjendja e brendshme në qytet për shkak të papastërtisë në qytet është shumë alarmuese. Zgjidhja e këtij problemi kërkon një strategji afatgjatë, dhe në këtë kontekst do inicoja krijimin e një programi edukativ i cili do të përdorej në përgatitjen dhe vetëdijesimin e nxënësve për një ambient më të pastër. Marrja e iniciativave të ndryshme për pastrimin e zonave të ndotura me participimin e qytetarëve dhe bërja e kësaj teme sa më aktuale kam përshtypjen se mundet të ketë efekt shumë pozitiv që të kemi ambient më të pastër dhe më të gjelbëruar në hapësirat publike.

Tjetër problem serioz është qasja institucionale ndaj rinisë së qytetit tonë, vërehet një mungesë organizimi të mirëfilltë dhe një mungesë e ideve për të dal nga kjo rrugë. Mungesa e një orientimi të tillë bën që rininë tonë, në të shumtën e rasteve e gjen nëpër kafe-baret e qytetit, në anën tjetër janë rritur dukshëm rastet e dhunës nëpër shkollat e komunës, dhe delikuenca tek të miturit është duke u shtuar në kontinuitet. Në këtë relacion, për të dal nga kjo situatë, nevojitet organizimi i sa më shumë programeve edukative, kulturore, sportive etj. Studentët në qytetin tonë, hasin në shumë probleme, e sidomos hapësira e pamjaftueshme për të lexuar dhe deficitin e literaturës shtesë për të lexuar, prandaj do të kërkoja alternative të shpejta për të bërë të mundur që sallat e leximit të kenë hapësirë më të madhe, dhe të jenë ambiente sa më relaksuese.

Këto janë disa nga prioritetet që do të kisha po të isha kryetar i komunës sonë, natyrisht se ka edhe shumë gjëra të tjera, por duhet të theksoj se vlerat që kam paraqitur kanë një karakter shumë post-materialist, dhe duke e ditur se ne si shoqëri jemi aq të materializuar, këto ide që kam dhënë do të duken për disa nga shtetet më të zhvilluara të Evropës, por meqenëse me një logjikë të shëndoshë ne po synojmë Evropën, atëherë mënyra më e mirë për të iu afruar Evropës është akceptimi i vlerave të tyre.

Për të e bërë të zbatueshëm këtë plan shumë pragmatist, kam përshtypjen, se duhet një vullnet i lart politik-shoqëror dhe esenë do e përfundoja me thënien: Aty ku ka vullnet politik-shoqëror për të i avancuar gjërat përpara, aty ka zgjidhje, ndërsa kur kemi mungesë të vullnetit politik-shoqëror aty gjenden arsyet.

11

NAKIE HOTI - "Sikur të isha kryetare komune"

Komuna prej nga vij unë ballafaqohet me shumë probleme dhe vetëm me një kryetar të përgjegjshëm dhe me një udhëheqje efikase gjërat do të ecnin më mirë. Lind pyetja çfarë do të bëja unë po të isha kryetare komune?

Sikur të isha kryetare komune gjithmonë do ta bëja atë që është më e mira dhe me e dobishmja për qytetarin. Së pari, në administratë do të angazhoja njerëz që punojnë me seriozitet, përgjegjësi, korrektësi dhe me efikasitet, të cilët do t'u ofronin qytetarëve shërbime efikase dhe të shpejta.

Në asnjë moment nuk do të lejoja që njerëz të papërgjegjshëm të angazhoja në komunë, që për shkak të papërgjegjësisë së tyre qytetarët të presin në radhe të gjata qoftë për pajisje me dokumente udhëtimi qoftë për shërbime të tjera. Akoma bashkatdhetarët tanë nuk kanë ardhur në pushime nga bota e jashtme dhe imagjinoni çfarë tollovie, çfarë radhë të gjata krijohen në komunë për tu pajisur me dokumente udhëtime dhe paramendoni çfarë kaosi do të ndodh kur të kthehen gjithë ata mërgimtar dhe kërkojnë që të pajisen me dokumente. Po që se do të isha kryetare komune do të punoja në përmirësimin e infrastrukturës rrugore në vendet rurale në mënyrë që jeta e qytetarit të jetë më e lehtë.

Asnjë para të tatimpaguesve nuk do ta keqpërdoroja, çdo para e tyre do të shkonte në vendin e duhur. Psh në komunën tonë kemi probleme më ujërat e zeza, unë si kryetare komune do të bëja shumë në këtë drejtim, nën udhëheqjen time çdo fshat do ta kishte kanalizimin, ujërat e zeza jo vetëm që dëmtojnë rrugët por edhe ndotin ambientin kështu që me buxhetin e komunës dhe me ndihmën e donacioneve të ndryshme do ta realizoja këtë projekt.

Si kryetare komune do të angazhohesha dhe do të jepja një kontribut të jashtëzakonshëm në fushën e arsimit, do të ndërtonim shkolla të reja në mënyrë që nxënësve t'u ofrohen kushte të mira, salla sportive, salla të kompjuterëve kur dihet se sot teknologjia ka përparuar shumë. Asgjë nuk është bërë në fushën e kulturës, të rinjtë bredhin rrugëve sepse nuk kanë ambiente, vende për argëtim, siç janë; sallat e kulturës, palestrat sportive, me shumë vende të gjelbëruara, lulishte.

Ne në vitet e 90-ta në fshatin tim kemi pasur shtëpi të kulturës dhe është djegur nga okupatori serb, dhe merreni me mend se dhjetë vite pas s'është bërë asgjë përveçse është rrënuar dhe është shndërruar në stacion autobusësh dhe kjo më neverit, në atë kohe kemi pasur ku ti zhvillojmë aktivitetet kulturore, si koncerte, shfaqje të ndryshme teatrale dhe sot nuk kemi, është tmerr, dhe menjëherë do ta kisha ndërtuar shtëpinë e kulturës jo vetëm në fshatin tim por edhe në fshatra tjera. Pastaj do të zgjidha problemin e parkingjeve, nuk do të lejoja asnjë moment që të rrezikohet jeta e këmbësorit nga veturat e parkuara nëpër trotuare.

Prioritet tjetër për mua do të ishte sektori i bujqësisë. Bujqësia është mjaft e zhvilluar por problemi qëndron se komuna nuk ka bërë asgjë në këtë drejtim. Unë si kryetare e komunës do tu dilja në ndihmë dhe do t'i mbështetja bujqit, do t'i ndihmoja në farëra dhe në plehra kimike. Atë çka e investojnë bujqit tanë nuk e nxjerrin as minimumin kjo për shkak se ne tregun kosovar kanë konkurrencë prodhimet tona. Duhet që urgjentisht të bëjmë çka është e mundur në këtë fushë. Bujkut ti ofrojmë mbështetje dhe garanci se që në momentin që do të dal ne treg prodhimi i tij do të ketë shitje dhe nuk do të ketë konkurrencë e jo të ndodh që me mund e sakrificë të arrin deri të vjelja e pemëve dhe perimeve dhe që nuk ka ku ta shes dhe të vie puna deri të hedhja e prodhimeve në lum siç ndodh çdo vit. Duhet t'u vihet në ndihmë jo vetëm në nivel lokal por edhe në nivel qendror, se Kosova i ka prodhimet e veta dhe janë shumë të shëndosha atëherë duhet që ndër-

marrim diçka në këtë drejtim.

Rahoveci ka të zhvilluar mjaft edhe vreshtarin dhe si kryetare komune do t'i inkurajoja vreshtarët që të punojnë sepse produkti i tyre siç janë rrushi, verërat dhe shira do të arrinin nëpër vendet evropiane.

Komuna e Rahovecit ka shumë të vrarë sidomos në fshatin Krushë e Madhe dhe Krushë e Vogël dhe pothuajse fshatrat kanë mbetur vetëm në femra dhe fëmijë. Dhe sot ajo femër që është mbajtëse e familjes e ka shumë të vështirë, për t'i ushqyer, rritur dhe shkolluar fëmijët. Dhe si kryetare e komunës do t'u dilja në ndihmë kësaj kategorie duke ju ndihmuar në çdo aspekt. Dhënie të librave falas, shërbime shëndetësore dhe çka është me kryesorja do t'i ndihmoja në arsimim që fëmijët e tyre të jenë lider të së ardhmes, si kryetare e komunës do t'u jepja bursa fëmijëve të këtyre familjeve që të shkollohen dhe të studiojnë.

Në fushën e shëndetësisë do të kisha investuar shumë. Dihet se në spital kushtet nuk janë të mira, përmes buxhetit të komunës dhe me ndihmën e donatoreve kisha ndërtuar ambulanca në çdo fshat por nëse nuk do të kisha mundur në të gjitha fshatrat atëherë të paktën në fshatrat që kanë me shumë banor.

Komuna e Rahovecit ka mbi 70.000 banor dhe me kontributin e gjithsecilit nga ne do ta kishim një jetë më të mirë dhe një mirëqenie më të mirë sociale.

Jam shumë e bindur se do të kisha bërë shumë më shumë se çka kanë bërë kryetarët tjerë.

Komuna ime është shtëpia ime, dhe njëjtë po si në shtëpinë time do të kisha punuar me zell dhe më shumë përkushtim, duke qenë gjithmonë prioritet qytetari dhe mirëqenia e tij sociale.

12

FISNIK MULA - "Sikur të isha kryetar komune"

Arsyeja se pse më shtyri që të shkruaj këtë ese është që të shprehi indinjatën time në mënyrën e qeverisjes dhe qasjes së problemeve që po i bën lider-shipet udhëheqëse të pasluftës në komunën time.

Roli i lidershit në Komunën time është mjaft i marginalizuar dhe është i fokusuar vetëm në një pjesë të popullatës e cila po përfiton tash e sa vite prej të gjitha sistemeve qeverisëse lokale. Vizioni dhe strategjia e këtij liderशिpi bazohet kryesisht në kryerjen e politikave ditore dhe në menaxhimin e rasteve emergjente të cilat paraqiten si rrjedhojë e mos krijimit të analizave apo planeve të veprimit qoftë ato afat mesme apo ato afat gjata, të cilat do të ndihmonin në qetësimin e situatës dhe në mbarëvajtjen e punëve të Kuvendit Komunal.

Cilësia e shërbimeve ndaj qytetarëve le për të dëshiruar duke pas parasysh që gjithnjë e më shumë qytetarët po e prolongojnë pajisjen me dokumente vetëm e vetëm që të mos presin në radhët e gjata që krijohen dhe në frustrimet e ndryshme me mito marrjet e shumta nga ana e personelit punonjës apo me hyrjen e personave të cilët nuk presin në radhë por e kanë të njohur ndonjërin prej personave ku ipen këto dokumente, edhe ambientet ku ipen këto dokumente lënë për të dëshiruar ku nuk ka asnjë infrastrukturë normale dhe adekuate për ushtrimin e këtij aktiviteti.

Pjesëmarrja e qytetarëve në vendim-marrje është mjaft e ulët, pse po e them këtë, duke u nisur nga pjesëmarrja e ulët e shoqërisë civile në vendim-marrje apo monopolizimi i një apo dy OJQ-ve në procesin e vendim- marrjes nuk mund të themi që ka transparence apo vendim marrje të gjerë.

Pastaj nuk ekziston një monitorim i mirëfilltë i shpenzimit të parasë publike, ku deri me tani kryetari nuk ka dal me ndonjë raport se si shpenzohen ato, ku shkojnë dhe çfarë beneficione kanë qytetarët prej pagesave të tatimeve të ndryshme që bëjnë, e jo të flas me metra të shtruara me asfalt ku edhe ajo punë nuk po kryhet aspak në mënyrë të kënaqshme, pra transparencë publike nuk ekziston në komunën time edhe pse kryetari krenohet që jemi ndër komunat që punohet më së shumti në Kosovë.

Do të isha ndal tani tek disa nga problemet të cilat do të isha marr në 100 ditshin e parë të punës si Kryetar Komune: Do të duhej që të kishte një Koordinim më të mirë të Punëve dhe Hapësirës në sektorin social duke pas parasysh që një shumicë e popullatës është duke jetuar në varfëri për të mos thënë atë të skajshme.

Në çështjet ekonomike deri më tani është folur shumë nga ana e Kryetarit se do të vijnë investitor (Arab) dhe do kemi bashkëpunime të frytshme (kryesisht me Kroacinë), por deri më tani ato nuk janë të prekshme, do të duhej që të punohet më shumë në targetimin e kompanive të cilat do të mund t'iu krijohen mundësi të favorshme për investim dhe hapje të bizneseve të tyre në, gjithnjë duke ditë që në të kaluarën e afërt qyteti im ka pas lidhje të shumta me ndërmarrje të ndryshme dhe të njëjtën kohë ka prodhuar produkte të pa finalizuar, pra do të duhej që të gjenden modalitetet dhe të ftohen që kompanitë e interesuara të bëjnë një studim dhe të paraqitet nga ana e Komunës për përparësitë që do të kenë në mbarëvajtjen e punëve.

Një tjetër çështje që është mjaftë e ndjeshme dhe ka mjaft për tu bërë është rikthimi i pronës Komunale. Gjë që nuk bëhet prej Komunës në këtë rast nuk do të kisha kritikë Kryetarin por të gjithë Kuvendin Komunal për lëshime drastike të pronës komunale dhe për dhënien me koncesion të vendeve të cilat nuk kanë qenë e parashikuar që të ndërtohej në ato vende, dhe çka është më e

keqja edhe dhënien e lejeve të ndërtimit pastaj dhënien e lejeve për ushtrimin e aktiviteteve biznese. Mendoj që kjo është një temë e cila ka shumë për tu bërë ku nuk është bërë asgjë që prej luftës e deri me tani dhe në të njëjtën kohë është një instrument mjaft fitim prurës për komunën nëse do të shfrytëzohej në mënyrë adekuate.

Një komponent tjetër është edhe forcimi i arsimit duke u nisur prej atij parashkollor, shkollor dhe atij joformal, dhe gjithnjë duke punuar për hapjen e Universitetit, ku në baze të studimeve para-prake është parë që komuna jonë do të ketë një përfitim shumë të madh si në sferën edukative, sociale dhe atë ekonomike dhe në të njëjtën kohë do të bënte lidhjen fizike të gjithë regjionit si në këtë anë të kufirit dhe anën tjetër të kufirit.

Dhe gjithashtu kthimi i trurit qoftë prej kryeqytetit po ashtu edhe prej vendeve perëndimore gjë që deri me tani kemi vetëm imigrim të popullatës për në komunat apo shtetet tjera për një stabilizim ekonomiko-social.

Bashkëpunimin rajonal do të kishte qenë një tjetër komponent e rëndësishme në vendosjen e kontakteve rajonale me komunat tjera dhe në shkëmbimin e përvojave të suksesshme në qeverisjen komunale.

Bashkëpunimi ndërkuftar gjithashtu do të ishte një prej komponentëve të cilat do të kishin marr një pjesë të mirë të vëmendjes, ku me anë të këtij bashkëpunimi edhe do të mund të përfitohej ndër të tjera edhe prej projekteve të Bashkimit Evropian. Një tjetër komponent do të ishte përgatitja e shërbyesve civil në aftësimin e tyre për përpilimin e projekteve të cilat do të kishin qenë pjesë e Instrumentit për Para Anëtarësim, hulumtimi dhe aplikimi i granteve të ndryshme për forcimin e qeverisjes lokale që janë pjesë e këtij Instrumenti dhe Agjencioneve tjera të bashkimit Evropian të cilat do të kishin ndihmuar në një zhvillim qoftë ai ekonomik, social dhe politik.

Pra këto janë disa nga pikat që do të më kishin tërhequr vëmendjen dhe të cila do të kisha punuar në 100 ditshin e parë të punës si Kryetar Komune për një mirëqenie sa më dinjitoze të qytetarëve të Gjakovës.

13

ADIL BYTYQI – “Sikur të isha kryetar komune”**Roli i lidershipit (vizioni dhe strategjia)**

Rolin e lidershipit do ta veja ndër prioritetet e para si kryetar. Në sistemin e tanishëm qeverisës në Kosovë nuk ka lider në kuptimin e plot të fjalës që ka ndikim në shtytjen e proceseve përpara me anë të lidershipit personal, domethënë nuk kemi liderë sidomos të Kryetarët e Kuvendeve Komunale që janë autoritativ si në popull ashtu edhe në institucionin qeverisës që ata drejtojnë. Unë do ta shfrytëzoja tërë potencialin dhe dijeninë time që të rris ndikimin sidomos në ekzekutiv dhe administratë. Këtë do ta kisha bërë jo në kuptimin klasik me anë të forcës dhe urdhrave të detyrueshëm, por duke shfrytëzuar mekanizmat dhe aftësitë komunikuese për tu sjell mirë me stafet punuese, duke i vizituar shpesh nëpër zyre për ti nxitur dhe duke ju dhënë kurajo për punë më të mirë dhe ofrimin e shërbimeve të mira për qytetarët etj.

Do të kisha qartësuar vizionin dhe strategjinë time që ta kapë pikën kryesore se çfarë duhet të bëj, pse jam aty dhe cilat janë të drejtat dhe detyrat e mia për postin që kam. Neve si komunë jemi prapa në zhvillim, jo krahasuar me komunat tjera të Kosovës ngase pothuajse të gjitha komunat janë në fazë të njëjtë zhvillimi por krahasuar me vendet tjera jemi të ngecur, kjo për arsye të njohura tani më botërisht, kështu që ne duhet të ecim jo hap pas hapi por me nga dy hapa, të paktën të mundohemi dhe të punojmë sa më shumë që të jetë e mundur që të përparojmë dhe ta zëmë hapin që e kemi të humbur krahasuar me vendet e rajonit.

Unë do të isha munduar që ti shfrytëzoj të gjitha mundësitë duke hulumtuar dhe kërkuar donacione dhe investime nga jashtë por edhe nga brenda në komunën tonë. Ne i kemi disa përvoja që na ka ofruar KFOR-i në Suharekë si me investime por edhe ndërlidhje komunash p.sh. me Felbahun në Gjermani pastaj kemi pasur disa investime nga shoqata dhe organizata të ndryshme si për rini por edhe investime kapitale të ndryshme. Andaj do isha munduar që me ato resurse që i kemi ne si komunë t'u ofrojmë kushtet e nevojshme investitorëve apo donatorëve të huaj që të zhvillojnë ndonjë veprimtari, të hapin ndonjë fabrikë apo diç të tillë në mënyrë që ta ulim numrin e të papunëve.

Nga qeveria e Kosovës do të kërkoja që nëse gjejmë investitorë që do të ketë interes të zhvillojë veprimtari të gjerë në komunën tonë që të ju ofroj rrymë dhe siguri për investimet e tyre. Do të vizitoja komunat e vendeve të zhvilluara për të ju kërkuar që të na ndihmojnë në infrastrukturë dhe fusha të tjera në mënyrë që në të ardhmen të jua kthejmë në ndonjë formë nëse na jepet mundësia.

Cilësi e mirë ndaj shërbimeve për qytetarët

(Risi për përmirësimin e shërbimeve, transparencë, luftë ndaj korrupsionit)

Në administratë do të filloja me reforma jo krejtësisht rrënjësore por do të kisha intervenuar në stafin që punon në administratë në disa vende kyçe, ku ndonjë punonjës administrate është shumë i moshuar, nuk ka përgatitje profesionale adekuate apo nuk e njih mirë punën me kompjuter do ja ndërroja pozitën dhe do ja gjeja vendin ku ai mund të kryej detyrën me përgjegjësi dhe dinjitet ndërsa në pozitën e tij do ta sillja personin adekuat me përgatitje profesionale ose të paktën të mbahen trajnime profesionale për punëtorët e administratës. Pastaj në bazë të kushteve dhe të mundësive buxhetore për të shtuar staf do të shtoja ndonjë zyrë për ta reduktuar maltretimin dhe për t'ua lehtësuar qytetarëve kryerjen e shërbimeve.

Për zhdukjen e korrupsionit do të ndërmerija disa veprime më konkrete bazuar në kompetencat e Kryetarit të Komunës. Siç e kemi të njohur korrupsionin në një mënyrë apo tjetër ekziston në çdo Komunë apo mund të themi në shumë shtete e të mos konkludojmë në çdo shtet. E për komunën time unë do të bashkëpunojë me këshilltarët dhe kolegët më të afërt për të mbajtur nën kontroll stafin administrativ, mirëpo ky bashkëpunim nuk do të ishte krejtësisht i mundshëm pa bashkëpunim edhe me qytetarët. Në mbledhje të zakonshme me qytetarët do t'ua kisha përsëritur që ta kenë në dijeni mundësinë që ta lajmërojnë çdo rast që kanë hasur apo dëgjuar, përmes kutive të cilat do ti kisha vendosur afër sporteleve apo përmes numrit kontaktues të telefonit. Kur të më ofroreshin dëshmi të arsyeshme dhe informata konkrete për ndonjë pjesëtar të stafit përmes mekanizmave të mi do të merrja masa ndëshkuese duke llogaritur të gjitha rrethanat pa kursyer masën më të rëndë (largimin nga vendi i punës). Mirëpo me ofrimin e shërbimeve të mira, lehtësimin e kryerjes së tyre dhe bërjen e qytetarit që të jetë i kënaqur me shërbimet administrative edhe qytetarët nuk do ta shihnin të arsyeshme që të mendojnë për të korrumpuar ndonjë punonjës administrativë siç ka ndodhur dhe vazhdon të ekzistojë një fenomen i tillë.

Pjesëmarrja qytetare në vendim-marrje

Ky është një proces gjatë të cilit shqetësimet e qytetarëve, nevojat, vlerat, pritshmërinë dhe problemet duhet të merren parasysh nga vendimmarrësit lokal. Unë po të isha Kryetar i komunës do të kisha marrë masa që përmes strategjisë së komunikimit, buletineve mujorë, mediave, njoftimeve, broshurave etj. do të kisha informuar komunitetin dhe organizatat lokale për aktivitetet, planet, politikat, vendimet, rezultatet e performancës së pushtetit vendor etj. Në mënyrë që komunitetit ti krijohet mundësia të përfshihet në vendimmarrje dhe të krijohet hapësira e duhur për tu dëgjuar zëri i tyre. Kjo do të kishte qenë edhe ndihmës për qeverisjen time për ti identifikuar nevojat e qytetarëve, për të siguruar burime shtesë dhe me konsensus të merren vendime dhe të realizohen politika dhe projekte tjera që kanë të bëjnë me interesin e qytetarëve që të mos ketë pakënaqësi në të ardhmen.

Do të praktikojta që të bëjë më shumë takime publike në të cilat mund të marrin pjesë çdo qytetar apo organizatë me interes në komunë. Me rregullore do ta propozoja shpeshimin e takimeve publike dhe qytetarët do ti informoja sa më shumë përmes mediave, afisheve dhe njoftimeve se kur dhe ku do të mbahen takime gjë kjo që shumë pak praktikohet dhe qytetarët nuk janë të informuar për këto debate.

14

SARANDA REXHEPI – “Sikur të isha kryetare Komune”

Se çka mundë të them lidhur me këtë temë të flasësh nga një kënd tjetër është shumë e lehtë se çka do të veprosh po të ishe në këtë pozitë është diçka tjetër prandaj do të mundohem të shkruaj diçka dhe besojë që jam në gjendje të shprehem me disa fjalë .

Mendoj që një kryetar i komunës për ti kryer me shumë sukses punë e tij së pari duhet të ketë buxhet të mirë që të ketë mundësi për ti kryer të gjitha punët për të cilat ka nevojë një komunë si dhe një numër i madh i fshatrave që janë të asaj komune.

Lidhur me këtë temë po e luaj rolin e kryetarit të komunës së Rahovecit

Mendoj që është e udhës të ia filloj nga ekonomia sepse kemi nevojë që të ringjallim ekonominë e vendit tone sepse komuna e Rahovecit është njëri ndër vendet më të njohura për kultivimin e rrushit, rakisë, verës, pemëve dhe perimeve, si dhe ju kisha dhanë përkrahjeje fermerëve për shitjen e këtyre mallrave si në tregun vendorë dhe atë në shtete fqinje.

Mendoj se kisha mbjell një pjesë të madhe të vendit me rrush për ta rritur ekonomin e këtij vendi po ashtu edhe punësimin e një numër të madh të pa punësuarve.

Ndërsa për administratën komunale të komunës së Rahovecit po edhe për shumë qytete tjera të vendit tanë një numër i madh i të punësuarve janë të thyer në moshë dhe nuk janë në gjendje që ti kryejnë punët ma aq shumë korrektësi dhe mund të them se ata nuk ecin me hapa të njëjtë me teknologjinë e ditëve të sotme këtë e them se në vendin tonë është një numër i madh i të rinjve të pa punësuar edhe pse shumica prej tyre i kanë edhe Fakultetet e kryera dhe janë të pa punë, disa fshatra të komunës së Rahovecit nuk i kanë edhe rrugët e rregulluar dhe nuk janë të lidhura në rrjetin e ujitë dhe të kanalizimeve e këto fshatra janë shumë të prapambetur dhe jeta e tyre në vende është shumë e vështirë ka raste që ata detyrohen që ti braktisin vendet e tyre këto janë ndër të pare që kanë nevojë që të bëhet ky investim dhe është i rëndësishëm.

Po ashtu duhet që të kujdesemi sa më shumë për rinin e vendit sepse vendi jonë ka një rini shumë të shëndoshë dhe të mos lejojmë që të shkatërrohet dhe të punojmë sa më shumë me ta që t'u mundësojmë shkollimin e tyre sa më të mirë.

Mendoj që një gjë e cila është shumë e rëndësishme është përkushtim të madh duhet ta kemi edhe ndaj familjeve të dëshmoreve sepse udhëheqësit e vendit tanë kanë pak kujdes ndaj tyre edhe pse ata kanë nevojë për shumë ndihmë dhe janë ndër të parët që e meritojnë mendoj që ka edhe shumë gjëra për të cekur pos a i përket kësaj teme besoj që është mjaftë.

15

ARSIM GASHI – “Sikur të isha kryetar komune”

Tre sekonda kryetar komune

Është ora shtatë e mëngjesit dhe unë veç jam bërë gati për t'u nisur në punë. Zyra e kryetarit të Komunës, nuk duhet të jetë e fundit që të hapet. Prandaj më duhet të nxitohem.

Janë bërë një muaj që kur unë fitova zgjedhjet për kryetar komune. Fakti që unë kam fituar me një rezultat tepër të ngushtë në raport me kundër kandidatin tim më gëzon më shumë, sesa ta kisha mbështetjen absolute. Rezultati absolut do ta vente në dyshim nivelin e demokracisë në komunë, apo do të më jepte një komoditet që të mos jem shumë i preokupuar për zgjedhjet e ardhshme ngase fitoren do ta kisha të garantuar.

Por nuk është vetëm rezultati ai që më bën të punojë më shumë. Gjatë një muaji fushatë, kam bërë një marrëveshje me qytetarët nëse ata ma besojnë mandatin dy vjeçar për kryetar. Rrugët e paasfaltuara, mungesa e ujësjellësit në shumë fshatra apo edhe ndërtimi i disa shkollave në zona të thella malore, presin dorën e shtetit. Tek e fundit votat i kam fituar mbi këto projekte që i kam bërë nga ekspertët e zgjedhur, tash bashkëpunëtorë të mi.

Uroj që votuesit e mi të më falin pasi projektin e parë të asfaltimit të rrugës, do ta fillojë në fshatin ku mora shumë pak vota. Ndryshe ky fshat është i kundër-kandidatit tim. Dua që qytetarët të më shohin si kryetar të të gjithëve; jo vetëm të votuesve të mi.

Por ajo që u nevojitet më shumë qytetarëve janë shërbimet e mira në komunë. Më nuk po shihen rreshta të gjatë duke pritur para sporteleve. Administrata i ka kuptuar drejt vërejtjet e mia të dhënë në një mbledhje të përbashkët që kishim në fillim të punës sime si kryetar. Pauzat e gjata me ose pa orar tash kanë marrë fund. Por edhe kushtet e punës, pasi komuna fitoi një projekt nga USAID, janë përmirësuar. Për shërbime të mira në komunë, morëm lëvdata nga qytetarët gjatë një debati të përbashkët që kishim këtë javë. E kam kuptuar rëndësinë që kanë debatet me qytetarë, prandaj këto do të jenë të rregullta dhe vendimet e komunës që kanë të bëjnë drejtpërdrejtë me qytetarë, do të merren në bashkëpunim me ta.

Qytetarët do të kenë të drejtë të marrin pjesë në bashkëqeverisjen e komunës sonë, e cila aktualisht konsiderohet si komuna më e varfër. Do të doja që këtë epitet komuna të mos e ketë pas përfundimit të mandatit tim. Projekti për hapjen e fabrikës për përpunimin e ujërave të zeza që do të krijoj shumë vende të reja pune.

Këtë vit do të hapet edhe parku industrial, projekt ky i filluar para një viti nga qeveria e Kosovës në bashkëpunim me komunën. Tash pritet finalizimi i këtij projekti nga i cili fillimisht do të punësohen 1000 qytetarë të komunës. Nga ata, një numër i madh do të jenë nga minoritetet. Romët dhe serbët, janë komunitet pakicë në komunë. Forma e vetme për të integruar ata në jetën shoqërore, është duke hapur vende pune në një kohë kur varfëria është emëruesi i përbashkët i të gjithave komuniteteve. Serbët kanë dhënë shenja se duan të integrohen në jetën shoqërore dhe politike të vendit. Kisha një takim me këtë komunitet ku i urova për Pashkët Ortodokse. Aty pashë gatishmërinë e tyre për t'u integruar në jetën shoqërore dhe politike në vend. Romët tash vetëm janë të integruar.

Më duhet ta pranoj se e kisha menduar më të lehtë pozitën si kryetar komune kur mora ofertën për

t'u kandiduar si kryetar. Koha e gjatë e qëndrimit tim në SHBA duke studiuar për Menaxhment në Universitetin e Haruardit, më kishte shkëputur pak nga realiteti i këtushëm. Më është dukur absurde kur kam kuptuar se grupe njerëzish në komunë, kishin krijuar një fuqi udhëheqëse pa pasur legjitimet. Dhe si absurde do ta vazhdoj t'i quaj këto tendenca të cilave u kam shpallur "luftë" edhe pse rrënjët ishin të thella. Por jo më të thella se bindjet e mia për të luftuar çdo dukuri negative në komunë e cila dita ditës po fillon ta kuptohet se mbështetja për njeriun nuk varet nga e kaluara e tij sado e lavdishme, por nga puna që ai bën për ta qar komunën përpara.

Partia që më kandidoi për kryetar, por edhe votuesit që ma garantuan këtë pozitë që unë kam, me votuan duke parë tek unë një karakter të fortë prej një njeriu të vendosur që të qojë gjërat deri në fund. Natyrisht, gjithnjë duke respektuar ligjin i cili është fuqia më e madhe për mua.

Kam përpara një mandat dy vjeçar por edhe shumë probleme të grumbulluara. Përpara kam shumë projekte dhe pas me ndjekin premtimet gjatë fushatës.

Eh, jo rastësisht thuhet se atë çka e mendon ditën e shoh në ëndërr natën. E gjitha paska qenë ëndërr. Vërtetë është ora shtatë e mëngjesit por alarmi i ziles më thërret për në bibliotekë. Mbase pas studimeve do të kem mundësi ta realizoj këtë ëndërr.

16

ZEHRIJE PLAKOLLI – “Sikur të isha kryetare komune”

Çelësi i çdo suksesi të një pune të organizuar është planifikimi i saj, e që në të vërtet nënkupton menaxhuesin ose liderin e saj. Që të jesh një lider që kërkon nga të tjerët të jenë të mirë së pari duhet të jetë vet i tillë.

Kështu që kryetari i komunës duhet të jetë një njohës i mirë e i thellë i jetës, i nevojave dhe kërkesave të komunitetit lokal. Ai duhet të jetë autoritativ (që i ka fjala peshë), i ndërgjegjshëm, i përgjegjshëm, njeri human, dhe si i tillë patjetër që do ta dojë komuniteti. Dhe vetëm nëse e duan njerëzit me të cilët punon ai, do të jetë i suksesshëm.

Po të isha unë lider komune, si amatore që do të isha në atë post, (duke mos qenë më parë e tillë), që në fillim do e përdorja „strategjinë” e komunikimit të sinqertë me të gjithë për rreth, do të thotë me ata të cilët do të punojë.

Do të përpiqesha të krijoja një miqësi kolegjiale me të gjithë dhe do të përpiqesha ti bindja ata që vetëm të gjithë së bashku dhe vetëm duke funksionuar secila pjesë-gjymtyrë e organizmit që quhet KOMUNË mund të shkojmë më tutje si komunitet lokal dhe si shoqëri përgjithësisht, vetëm si të tillë mund të jemi të dobishëm drejt së ardhmes.

Po ashtu që në fillim do ti siguroja ata që bazuar në ndershmerinë time të mëhershme do të jem e ndershme tutje dhe do të kërkojë të jenë të tillë ndaj punës dhe ligjit që të gjithë. Në këtë mënyrë do të kërkoja që të sigurohesha nga ata me të cilët punoj, dhe ata të sigurohen nga unë që nuk do ta keqpërdorim pasurinë e shoqërisë por do ta shndërrojmë atë në zhvillim. Kjo do të thotë luftë korrupsionit!

Përveç kujdesit serioz për raport të ndershëm me buxhetin dhe pasurinë shoqërore, do të kujdesesha edhe për shfrytëzim sa më racional të tij. Kështu që do të dilja në teren, do të takoja njerëzit kompetent në çdo aspekt, që të njihesha me problemet nevojat dhe kërkesat e qytetarëve. Vetëm kështu do të mund ta bëja planin më real dhe do të mund ta organizoja punën sipas prioriteteve.

Kurse, apriori, prioritet do ti jepja kyçe në punë të të rinjve të kualifikuar dhe pensionimin edhe të parakohshëm të kadrove të vjetra (respekt për më të vjetrit por skadencia vepron gjithkund), që janë në poste kyçe, për ti zëvendësuar me të rinjtë të cilët me rininë dhe vullnetin do të mund të bënin mrekulli.

Do ti bëja vetës agjendë edhe jashtë protokollare që sa më shumë të kem takime e komunikime me njerëz e në mënyrë të posaçme me shkolla. Do ti preferoja shefit komunal të arsimit që të ndikojë, që nëpër plane të shkollave të fus edukim për kujdesin ndaj ambientit dhe ngritjen e ndjenjës estetike të nxënësve, (e cila na mungon tepër neve si shoqëri, në mënyrë gjenerale) dhe në mënyrë të vullnetshme t’u preferojnë nxënësve që të kontribuojnë në këtë aspekt kudo në ambientet e tyre: shkollë, rrugë, shtëpi, lagje.....(me mbjellje, pastrim, etj).

Ndër prioritetet e mia do të ishte edhe riparimi i ndërtesave të vjetra se nuk do të thotë se gjithçka e vjetër është e keqe dhe duhet rrënuar, por duhet mirëmbajtur ato. Dhe duke i riparuar ato e jo duke i rrënuar shumë shpejtë do të ndërronte pamja e qytetit pa shumë shpenzime. Pastaj edhe do të ndërtoja të nevojshmet dhe të mundshmet.

Kapitull i veçantë i punës sime do të ishte kujdesi ndaj ambientit në mënyrë që ai të bëhet sa më i

këndshëm për syrin dhe shpirtin e qytetarëve dhe të ndikojë kjo edhe në disponimin e tyre ndaj jetës. Edhe këtu do të qasesha shkollës për ndihmë, sepse krijimi i ambienteve të këndshme është një mundësi e lehtë dhe shumë rekreative për moshën e re të cilët nëse organizohen, punojnë dhe argëtohen. Kjo i bie menaxhim pozitiv i energjisë së të rinjve, të cilën mjerisht ata e shpenzojnë kot, në rrugë në bar-kafe, internet-kafe, etj. Specifikë e punës sime (ndoshta edhe jashtë kompetencave të mia) do të ishte edhe takime me prindër të nxënësve nëpër shkolla për të kërkuar nga ata që të merren më me seriozitet me fëmijët e tyre dhe për ti vetëdijesuar ata që fundament i edukatës së fëmijëve është prindi- familja, e jo shkolla – institucioni, sepse, si pasojë e kujdesit jo të mjaftueshëm të prindërve ndaj fëmijëve po vrazhdësohen të rinjtë e po eskalon dhunshëm shoqëria. Kështu që etimologjia e problematikave sociale shpesh rezulton nga pakujdesia e prindërve.

Si objektiva të mia në mënyrë të veçantë do të ishin edhe dy moshat më delikate të shoqërisë: fëmijët dhe pleqtë. Do të kujdesesha për të dy brezat që ta kenë nga një kënd adekuat për ta në mënyrë që aty do të zhvillonin aktivitete vullnetare të dobishme, kreative e argëtuese. Plotë gjëra modeste kanë funksion tepër pozitiv dhe për këto gjithherë janë mundësitë vetëm duhet pasur ide. Kemi edhe kuadro adekuate për këtë punë: sociolog, pedagog, psikolog, njohuritë e të cilëve duhet shfrytëzuar në këtë aspekt.

Një tjetër objektive e imja është funksionalizimi dhe tërheqja e vëmendjes së të rinjve kah kinema-ja dhe teatri, duke i angazhuar këtu njerëz profesionalist. Do t'i përkushtohesha shumë kulturës sepse kultura reflektohet dobishëm në çdo aspekt edhe jashtë kulturor: në ndërgjegje të punës, në kujdes për ambientin, në shëndet, në sjellje dhe raport njerëzor etj. Puna tjetër që do ta bëja është botimi dhe shpërndarja e një fletushke mujore ku do të paraqiteshin sukseset dhe mangësitë e punës në komunë dhe komunitet përgjithësisht, dhe po aty do të shpreheshin të gjitha mendimet, ofertat, kërkesat, idetë, e vlerësimit të qytetarëve për gjithçka. Në këtë mënyrë edhe ata do të mer-rrnin pjesë në çdo vendimmarrje për komunën-komunitetin, në mënyrën më transparente të mundshme.

Kështu të gjithë do ti kishim edhe angazhimet, edhe rezultatet edhe përjetimet të përbashkëta.

17

FEHMI AJVAZI – “Sikur të isha kryetar komune”

Për çdo kandidat që synon postin e të parit të komunës, pyetja themelore është: çka, nëse e fitoj garën...? Qeverisja lokale, ka ndryshuar shumë. Përditë rriten kërkesat qytetare për jetë të mirëqenshme, shtohen nevojat për ligje më të decentralizueshme dhe efektikase. “Inputet dhe outputet”, në të vërtetë na shtojnë drejt kujdesit dhe rritjes së vizionit tonë, të strategjisë për të pas qeverisje efektive dhe në përputhje me normat standarde politike dhe administrative që lypsen në trendet e brendshme dhe, ndërkombëtare. Posti i kryetarit është strategjik për demokracinë, qeverisjen e vërtetë, është “zinxhiri” për pushtetin më të mirë lokal.

Roli i lidërshiptit (Vizioni dhe Strategjia)

Si kryetar komune, qysh në fazën elektorale- zgjedhore, do të isha fokusuar rreth propagandimit të vizionit qeverisës. Më shkurt: në premtimet që janë të arritshme. Por standardi i “etikës dhe moralit” të udhëheqësit apo lidërshiptit të pranueshëm, asnjëherë nuk duhet shmangur. Pa etikë dhe moral personal, pa kredo qeverisëse - profesionale, nuk mund të jemi të suksesshëm në krye të mekanizmave që determinojnë pushtetin politik, ekzekutivin dhe gjithë administratën. Mbi bazë të këtyre zakoneve dhe normave, sinjalizojmë qytetarin se administrimi dhe udhëheqja, do të fokusohen mbi strategji të sigurta që synojnë rregullin, përgjegjësinë dhe kompetencat institucionale efektive. Me kohë, duhet pasur vizion të qartë në tri çështje serioze:

- në zbatimin e ligjit,
- në efikasitetin e ligjit dhe qeverisjes,
- në kontrollin dhe përgjegjësitë udhëheqëse.

Pse? Duke e zbatuar ligjin, arrijmë të faktet që “jemi për qytetarët në udhëheqje, dhe jo qytetarët për ne”, deri në fund të mandatit. Duke e zbatuar ligjin, ne dëshmojmë besueshmëri, siguri, qeverisje që shkon deri te caqet më të largëta: qendër/periferi (Hangtingtoni). Shtrirja efikase e pushtetit ligjor, na mundëson ndërtimin e mekanizmave të qëndrueshëm qeverisës (pushteti ekzekutiv). Në këtë mënyrë, krijohet zinxhiri aktiv: qytetar–pushtet dhe anasjelltas. Qartë: pushteti bëhet më efikas, transparent, i pakorruptueshëm dhe në shërbim të qytetarit, njëzet e katër orë. Kur ligji zbatohet me konsekuencë dhe efikasitet nuk mungon përgjegjësia, kurse rezultatet pozitive të pushtetit kthehen në standarde. Etika dhe ligji për institucione të përgjegjshme, janë thelbi i demokracisë dhe shtetit ligjor. Mbi këto kondita, vjen duke u forcuar koherenca e sistemit, siguria, besimi qytetar tek institucionet, rriten kapacitetet për strategji që mbështeten në veprime absolute, praktike.

Ndërtimi i vlerave administrative-institucionale, nuk mund të bëhet pa bashkëpunim komunë–qytetar, dhe anasjelltas. Si kryetar komune, mendoj që është shumë me rëndësi ndërtimi i besimit në institucione dhe lidërshiptit. Bartja e pushtetit sa më afër qytetarit, rritë përgjegjësitë e dyanshme por, sidomos të këtij të fundit: në zbatimin e ligjit, në pagesën e taksave, në respektimin e organeve të pushtetit, në respektimin e ambientit, të sistemit etj. Me teknologjitë teorike të pushtetit dhe qeverisjes, duhet të synojmë shtrirjen tonë në rrafshin e pushtetit praktik, që është krejt strategji themelore për një kryetar komune.

Cilësi e mirë ndaj shërbimeve për qytetarët (risi për përmirësimin e shërbimeve, transparencë, luftë ndaj korrupsionit etj.)

Si kryetar komune, në fazën tjetër, atë të zbatimit praktik të pushtetit (mandatit), do t’i shpërndaja

prioritetet e strategjisë qeverisëse. Këtu edhe qëndron vlera, suksesi, mirëqenia, përfaqësimi, përgjegjësia etj. Pra, në idenë kryesore: si të funksionalizohet sa më shumë qeverisja? Duhet thënë që ka shumë modele të qeverisjes lokale. Hallkat që shpërndajnë liri (jo varshmëri) për pushtetin lokal nga pushteti qendror, janë të shumta. Mjafton ta shohim decentralizimin sipas UE-së, pastaj decentralizimin në Evropën Juglindore. Por, është e rëndësishme që kompetencat e pushtetit lokal sot, janë solide për çdo vend dhe komunë. Mirëpo, duke mos i anashkaluar modelet, përvojat, bashkëpunimet mendoj që duhet asistuar në sinkronizim të problemit. Në Kosovë, ka shumë faktor të djeshëm (historik), dhe të sotshëm që ndikojnë në qeverisje. Ta zëmë, nuk mund të pretendojmë qeverisje të njëjtë lokale si në komunën e Gjilanit, si në atë të Mynhenit, Mariborit, Parisit etj. Megjithatë, disa gjëra janë të njëjta: ardhja me kohë në punë, respektimi dhe shërbimi me kohë për qytetarin, ikja nga abuzimi me pushtetin, transparenca, shmangja e domosdoshme nga korrupsioni, shërbime të vlefshme dhe efikase administrative, shërbime të barabarta pa dallim gjinie, race, identiteti etj. Të gjitha: duke e afruar pushtetin sa më afër qytetarit, në praktikë. Bie fjala, deri sa në Suedi mund të merren dokumentet personale përmes internetit, a nuk mundemi ne që ta ndërtojmë një administratë që është më efikase dhe më e përgjegjshme në zyre (ex-oficio)?

Pjesëmarrja qytetare në vendim-marrje:

Dallimet janë kruciale, por ne po shkojmë rrugëve të pushtetit ligjor, dhe qeverisjes demokratike pa kthim mbrapa! Prandaj, mendoj që si kryetar komune do t'i përdorja me kujdes kompetencat, projektet dhe modelet, mekanizmat, buxhetin duke i krahasuar dhe analizuar për të nxjerrë nevojat, mundësitë, përvojat, cilësitë, kërkesat etj. Më qartë: do të insistoja që qeverisja lokale (menaxhimi i saj), t'i përshtatet sa më shumë hapësirës politike dhe ekonomike, asaj administrative, demografike, kulturore etj. Duke kërkuar forma dhe mjete për zhvillim dhe mirëqenie (në infrastrukturë, rrugë, demokratizim, në bujqësi, prodhimin), insistimi im do t'ishte në shtrirjen e demokracisë dhe plotësimin inpleteve që vijnë sidomos, nga qytetarët. Mendoj që mund të gjenden shumë forma, standarde, begatime dhe perspektivat për zbatimin me përgjegjësi të postit të Kryetarit të Komunës. Ja disa ide:

Grumbullimi dhe analizimi i prioriteteve: me thelb afatshkurtra, dhe afatgjata.

Profesionalizimi i kuadrit, efikasiteti në implementim të detyrave-përgjegjësi.

Grumbullimi efikas i taksave por, edhe gjetja e rrugëve që ato patjetër t'u kthehen qytetarëve në masën e duhur: me projekte dhe vepra.

Investimi në propagandë me moton: "Pushteti është i qytetarit": reklamë, debate, takime etj.

Pjesëmarrja e qytetarëve në komisione – panele të ndryshme kur aprovohen rregulloret, ligjet, kur ndahen tenderët, kur bëhen investime kapitale etj.

Themelimi i një dhome të veçantë përfaqësimi jorezident, ku do të përfshiheshin lagjet dhe fshatrat e komunës. Kjo "dhomë", do të prezantohej me nga një përfaqësues. Do të mund të mblidhej, jo më shumë se një herë në muaj dhe, do të mbikëqyrej nga kryetari i komunës lidhur me nevojat, kërkesat,problemet etj.

Akreditimi i një telefoni "SOS" për qytetarët në zyrën e Kryetarit.

Zvogëlimi i privilegjeve të tepërta për kryetarin, nëpunësit dhe ekzekutivin.

Ruajtja dhe forcimi i domosdoshëm i imazhit të lidërshiptit dhe qeverisjes.

Kategorizimi i nevojave qytetare: prioritetet e shkollës, punësimi, prodhimi etj.

18

ALMA GJONGECAJ – “Sikur të isha kryetare komune”

Motoja ime do të ishte:

**“DINJITETI I KRYETARIT TË KOMUNËS DO JETË:
ZGJIDHJA E PROBLEMEVE TUAJA”.**

Roli i Lidershipit (vizioni, strategjia)

Autoriteti drejtues i pushtetit vendor është Kryetari i Komunës, i cili në vizionin e tij të drejtimit apo lidershipit të tij politik dhe institucional duhet të bazohet mbi disa parime strategjike si: Pushtet publik të decentralizuar, transparent, demokratik dhe ripërtëritës në komunitetin vendor, bazuar në standardet evropiane dhe atyre të konstitucionalizuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Vizion të qëndrueshëm demokratik - politik dhe juridik në kuadrin e politikave integruese dhe zhvilluese duke rritur pavarësinë e pushtetit vendor. Detyrimi kryesor i qeverisjes vendore i takon nivelit të parë të pushtetit vendor lidhur me hartimin dhe zbatimin e politikave rajonale të zhvillimit me funksionet që disponojnë në fushën e infrastrukturës vendore dhe shërbimeve publike, me karakter social, kulturor, sportiv, në zhvillimin ekonomik vendor për rendin e mbrojtjen civile, si dhe në **Funksionet e përbashkëta** dhe **funksionet të deleguara** nga një nivel në një tjetër. Me anë të këtyre funksioneve organet vendore ushtrojnë kompetencat e tyre lidhur me mirëmbajtjen, zhvillimin, investimet, infrastrukturën etj., si dhe me nevojat sociale të komunitetit në tërësi, procese këto të cilat kërkojnë mjaft punë dhe përpjekje për zgjidhjen e problemeve që lidhen me to, dhe janë pikat kyçe të sigurimit të mirëqenies dhe realizimit të strategjisë së pushtetit vendor.

Ky pushtet duhet të jetë autonom në vendimmarrje për:

- bazën e nivelit të taksës ,
- procedurat e administrimit dhe mënyrën e mbledhjes së taksave vendore,
- përjashtimin e lehtësimin e kategorive të ndryshme të komuniteteve , në pagimin e taksave ,
- përdorimin e të ardhurave të grumbulluara nga taksat vendore.

Me anë të lidershipit decentralizues pushteti vendor synon t’u japë qytetarëve dhe përfaqësuesve të zgjedhur të tyre me shume pushtet në procesin e marrjes së vendimeve publike si dhe krijon mundësinë që vendimet e marra me një pjesëmarrje më të gjerë të fokusohen drejt interesave të shoqërisë. **Kompetencat e funksionimit të pushtetit vendor konsistojnë në:** - **Mbështetjen institucionale** edhe në organet e qeverisjes në: -Hartimi i legjislacionit për funksionet e veta dhe funksionet e përbashkëta, -Hartimi i metodikave, udhëzimeve, manualeve, projekteve, mënyrat e sigurimit administrimit dhe të planifikimit të mundësive lidhur me nevojat e kërkuara nga shoqëria dhe familjet në nevojë apo pakicat, etj. - **Rritjen e kapaciteteve menaxhuese** - **Autonomin vendore** - **Kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave** - **Respektimin e Kushtetutës, ligjeve dhe aktet e nxjerra në bazë në zbatim të tyre.**

Cilësi e mirë ndaj shërbimeve për qytetarët

(risi për përmirësimin e shërbimeve, transparencë dhe luftë kundër korrupsionit).

Me anë të funksioneve dhe kompetencave organet vendore duhet të rrisin akoma më tej përpjekjet për hapa të mëtejshëm në:

- Programet për banesat me kosto më të ulët.
- Programe të pajisjes së truallit me infrastrukturë.
- Shërbimi Social

Programeve Sociale në ofrimin e shërbimeve për individë dhe familje në risk nëpërmjet mbështetjes apo hapjes së qendrave ditore komunitare për:

- të moshuar të vetmuar dhe në nevojë; persona me aftësi të kufizuara; fëmijët dhe familjen; të rinj në risk.
- Ofrimin e shërbimeve për kategoritë në nevojë nëpërmjet referimit të rasteve në organizata dhe qendra që ofrojnë shërbime për:
- fëmijë të rrugës; fëmijë që punojnë; fëmijë jetimë; gra të dhunuara, të divorcuara; të moshuar.

Pjesëmarrja e qytetareve në vendimmarrje

Vlerësimin e familjes kujdestare dhe fëmijës që vendoset nën kujdestari. Vlerësimin e familjes që merr në kujdestari persona me aftësi të kufizuara. Ofrimin e shërbimeve gjithëpërfshirëse për fëmijët me aftësi të kufizuara në procesin e integritetit të tyre në çerdhe dhe kopshte si dhe përmirësimin e mëtejshëm të të gjithë infrastrukturës mjedisore, ku shtrihet segmenti i jetesës së popullsisë në nevojë. Të rritet bashkëpunimi midis këtij institucioni publik me sektorin privat, për qëllime të përbashkëta dhe zhvilluese në infrastrukturë si në; shkolla, ambiente pushuese, shlodhese, sportive, kulturore etj. me qëllim përmirësimin e jetesës në komunitet duke i nxitur individët të marrin pjesë në rastet e zgjidhjes së konflikteve, bashkëjetueses në komunitet, vendimmarrje dhe aftësimin e fëmijëve për të mbrojtur të drejtat e tyre, për t'u organizuar dhe vetë-drejtuar, për vendimet dhe pavarësinë e alternativimin e ndihmës ekonomike me shërbime dhe punët publike si dhe ndihmesën që u jepet familjeve me probleme sociale për punësim dhe në procesin e zhvillimit dhe edukimit të fëmijëve të tyre. Iniciativë për përmirësimin e mundësive të kualifikimeve profesionale me anë të bursave të studimit për gratë dhe vajzat në nevojë për të përmbushur aspiratat e tyre dhe për t'u aftësuar profesionalisht me qëllim integritetin e tyre në tregun e punës dhe rritjen e shanseve në punësim me qëllim fuqizimin dhe prosperitetin e gruas si faktori më i rëndësishëm në edukimin e familjes dhe zhvillimin e shoqërisë për t'u përballur me sfidat e shumta të jetës së përditshme me qëllim ndikimin sa më të lartë e direkt në rritjen profesionale të tyre për përballje me problemet ekonomike.

Iniciativat sensibilizuese të angazhimit të popullsisë në integritetin demokratik të pjesës tjetër të zhvilluar të shoqërisë, me anë të ndërmarrjeve riintegruese të kësaj shtrese, me anë të prezantimeve e fushatave të ndryshme mediatike audio-vizive e të shkruar.

Qytetarët do të kenë integritet e zhvillim në bazë të zgjedhjes së individëve për t'i udhëhequr e përfaqësuar. Por e para është të jetuarit apo të bashkëjetuarit me njëri tjetrin në frymë harmonie dhe mirëkuptimi, në luftë kundër korrupsionit, terrorizmit, e krimeve kundër njerëzimit, jo hakmarrje, por falje dhe zemërgjerësi, duke ndihmuar kështu shtetin më të ri të botës të ketë lirinë e pavarësinë e tij në sovranitetin e tij si shtet për të pasur në të ardhmen një shtet demokratik, duke pasur një bashkëjetesë të pastër multietnike dhe bashkëpunim ndërkombëtar.

Si përfundim duke qenë se titullari i bashkisë së një qyteti, si udhëheqës i një prej strukturave më të rëndësishme vendore i cili zgjidhet nga populli si përfaqësues i të gjitha çështjeve të tij vendore, mendoj se: Populli duhet të bëjë një zgjedhje të përgjegjshme duke menduar se janë ata përgjegjësit kryesorë të zgjedhjeve të bëra, për përfaqësuesin e tyre dhe për ndryshim, ndonëse fillimi i ndryshimit duhet bërë nga vetë personi që dëshiron të shoh ndryshim në botë, pasi e ardhmja u përket atyre që besojnë në forcën e tyre të brendshme për ndryshim pasi zgjedhjet e bëra në të kaluarën janë e tashmja, dhe zgjedhjet e bëra sot do të jenë e ardhmja, dhe fitorja u përket atyre të cilët paraprijnë dhe guxojnë të paret të sjellin ndryshimin dhe zhvillimin e një kombi dhe këta njerëz janë të gjithë kosovarët së bashku.

19

BESNIK PEÇI - "Sikur të isha kryetar komune"

Të qenurit kryetar komune sot nuk është mision i pamundur, e sidomos tash në Kosovën e lirë dhe të pavarur, duke iu falënderuar atyre që dhanë jetën dhe atyre që derdhën gjakun për këtë tokë të shenjtë në këtë mision tashmë e kemi në duar tona. Neve të rinjve na mbetet të punojmë, të studiojmë me qëllim që ti shërbejmë me dinjitet vendit tonë. Ti ndihmosh popullit tënd, të punosh me dinjitet për të nuk mjafton vetëm të dish por duhet edhe të duash. Duhet të jemi të vetëdijshëm se edhe po që se jemi të bardhë si bora nuk i shpëtojmë dot gojë-kqinjëve, mirëpo ne duhet të punojmë që një ditë ardhmëria jonë të na uroi për atë çka kemi punuar dikur...

Të jesh administratorë i një vendi pa administratë do të thotë se nuk je askush. Të jesh menaxherë i një firme të paformuar do të thotë të jesh vetë emërues, të jesh mësues e mos të dish të mësosh është injorancë, mirëpo të jesh kryetar komune duhesh të jesh administrator i shkëlqyeshëm, menaxher i dëshmuar, mësues i respektuar dhe individ i dalluar. Është e vështirë që krejt këto virtyte të gjenden tek lideri ynë, tek i pari i qytetit ai i cili do udhëheqë me ne ai shpëtimtari të cilin e pagëzuam me aq dashuri, më e pakta që presim prej tij është zhgënjimi.

Është sakrificë përgjegjësi dhe altruizëm ta pranosh një postë të tillë në këtë kohë të pakohë, mirëpo njëkohësisht është nder dhe krenari që dijen dhe aftësitë e tua t'ia dhurosh me nder rritjes dhe zhvillimit të vendit tënd vendit ku ke lindur. Asnjëherë nuk duhet kontestuar dëshirën dhe vullnetin për ti japë dijen, përvojën dhe kur është nevoja edhe jetën atdheut. Jam i pasionuar pas thënies së presidentit amerikan i cili thoshte "nuk duhet të pyesësh kurrë se çka bëri vendi yt për ty! Por çka bëre ti për vendin tënd..

Mundësitë buxhetore që kanë sot komunat e Kosovës e kushtëzojnë mundësitë për operim dhe dalje nga kjo krizë, mirëpo ato mundësi neve nuk mund të na i marrin ëndrrat tona, dëshirat tona dhe vullnetin tonë që një ditë komuna ime të jetë model për shtetin tim Kosovën pse jo edhe për komunat e shteteve të Evropës.

Si mund ta bëjmë këtë? Si mund të integrohen minoritetet? Si mund ta zhdukim varfërinë? Si mund ta ruajmë dinjitetin e atyre që dhanë krejt çka patën për këtë tokë të shenjtë? Si të motivohen qytetarët që të ecin përpara? Si të motivohen nxënësit dhe studentët e ardhmja e vendit tim? Si ta rregullojmë infrastrukturën?

Çka duhet të bëjë të kemi ujë të mjaftueshëm rrym gjithashtu? Si ta ruajmë shëndetin e qytetarëve të mi dhe si të ju shërbej atyre që mos të presin për shërbimet e shpejta dhe efikase që duhet të ofroj komuna ime.

Është argument që këto që lartë cekëm janë sfida të vështira dhe vërtet problem të realizohen për një kohë të shkurtër, mirëpo këto sfida ne duhet ti kuptojmë si ftesa që presin të dijsmin të ju kundërvihet me sukses. Ballafaqimi me sukses përball këtyre sfidave është plotësisht mision i mundur.

Që një popull të jetoj i lirë në paqe dhe harmoni pjesëtarët e tij duhet të kenë marrëdhënie të shkëlqyeshme. Për ta përmbushur këtë synim duhet integruar pakicën me shumicën, kjo arrihet duke gërshetuar interesat nga të gjitha fushat. Bashkëpunimi duhet të startoi nga këndi ekonomik për tu zgjeruar në bashkëpunim edukativë mësimorë. Mjetë për këtë bashkëpunim janë organizimet e konferencave lokale dhe rajonale për integrim dhe duke i respektuar dhe motivuar ata që

kanë iniciativë integruese.

Varfëria është sfidë e çdo lideri në mbarë botën, edhe në sfidohemi nga ajo, varfëria zhduket me punë, qëndron fakti se në komunën time ka pak hapësirë për vende pune mirëpo ka rrugëzgjidhje për gjithçka. Si i pari i komunës planifikoi që ta zbusë papunësinë e me këtë ta reduktoj, eliminoj varfërinë. Ky synim arrihet me marrëveshje me institucionet kreditore që funksionojnë në botë dhe me koordinim të vazhdueshëm me qeverinë qendrore, kërkesa jonë do të ishte që të marrim kredi me kamatë simbolike kjo kredi do ishte infuzion për funksionalizimin e fabrikave gjigante që ka Kosova, funksionalizimi i këtyre fabrikave do zbusë papunësinë dhe do të reduktonte varfërinë, ky veprim i qëlluar do largonte të papunësuarit nga rruga dhe perspektiva e tyre tashmë do dukej me ngjyra jo si dikur.

Ata të cilët dhanë krejt çka patën që ne ta gëzojmë këtë copë lirie, ata të cilët lanë jetimët të vuajne dhe ata që humbën gjymtyrët e tyre për këtë liri patjetër janë kurbanet e kësaj pavarësie që po e gëzojmë, prandaj ne atyre duhet kushtuar kujdes dhe vëmendje të veçantë. Jetimët e dëshmorëve duhet ti favorizojmë, familjarëve të tyre duhet të ju ndihmojmë. Ndërsa për invalidët "dëshmorët e gjallë" të kombit tonë tu ndihmohet për mirëqenie, tua lehtësojmë qarkullimin, ti nxisim ta duan jetën dhe tua ruajmë dinjitetin.

Ajkës se qytetit nxënësve dhe studentëve të cilët me plot sakrificë shkollohen për tu aftësuar edhe ashtu me kushte të vështira duhet të motivohen me mirënjohje dhe bursa shkollimi pasi që një ditë ata do të jenë në shërbim të po këtij qyteti.

Infrastruktura duhet përmirësohet sepse ajo kushtëzon investimet nga jashtë prandaj asaj duhet kushtuar kujdes i veçantë.

Këto pasuri natyrore që i dhuroi Zoti bëjmë mirë ti shfrytëzojmë me mençuri.

Uji i Kosovës duhet shfrytëzuar për ujësjellës dhe hidrocentrale.

Në prijmë në Ballkan me rezerva të ngjillit ndërsa rrym kemi më së paku.

Lumturia jonë kushtëzohet nga shëndeti ynë. Ky sistem shëndetësor që funksionon tani është i gabuar. Duhet që sa më parë të bëhen sigurimet shëndetësore, sa më parë të bëhet akreditimi i institucioneve shërbyese shëndetësore që qytetari të pranojë shërbim të sigurt.

Çka të bëjmë me radhët e gjata në komunë? Si të anashkalojmë këtë kaos njerëzor?

Mendojmë se zgjedhja është digjitalizimi i shërbimeve.

Mendoj që problemet që lartë cekëm paralizojnë zhvillimin e jetës normale të njerëzve në komunën time...

20

HAJDIN ISLAMI – “Sikur të isha kryetar komune”

Vendimi im për zhvillimin e Komunës merret bashkërisht me qytetarë

Duke u nisur nga fakti se banorët e komunës janë të etur të shohin risi në qeverisjen lokale por edhe në përmirësimin e kualitetit të jetesës në të gjitha sferat e jetës unë do të përpiqesha që ta kryeja me nderë dhe profesionalizëm detyrën time si kryetar komune. Zbatimi i ligjit, bashkëpunimi me komunitetin, transparenca e plotë me mediat si dhe pjesëmarrja e shoqërisë civile në vendimmarrje janë disa nga pikat kyçe që unë si kryetar komune do t’ia parashtroja vetës që në ditën e parë të punës sime në këtë pozitë.

Veprimet dhe vendimet e rëndësishme komunale për çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me qytetin por edhe me komunën në përgjithësi do t’i bëja gjithnjë në debate me qytetarë si dhe do tu mundësoja të gjithëve që së paku dy muaj të bëjnë propozime, komente, parashtrim të ankesave si dhe do të kërkoja që për vendimet e rëndësishme Kuvendi Komunal të konsultohen edhe me shoqërinë civile si dhe profesionistët e fushave të caktuara.

Angazhim i përhershëm i imi si kryetar komune do të ishte krijimi i një ambienti tërheqës dhe të sigurt për investime dhe investitor duke u bazuar në resurset e mëdha natyrore dhe njerëzore që posedon komuna.

Strategjinë time lokale për zhvillimet ekonomike, kulturore, arsimore, sportive, shëndetësore do ta bazoja gjithnjë duke u mbështetur tek kuadrot që janë brenda qeverisë komunale por duke mos lënë anash për asnjë momentet edhe ata ekspertë që ka komuna ime.

Sukses timin do ta konsideroja atëherë kur banorët por edhe i gjithë spektri politik lokal do të bashkëpunonin me mua si dhe do të më besonin se jam duke i përfaqësuar të gjithë njësoj duke mos e dalluar askënd pa marrë parasysh se cilit komunitet, parti, lagje apo fshatë i takon, prania e barabartë e investimeve të komunës në çdo pjesë të komunës do të jetë një tjetër tregues se askush nuk diskriminohet apo privilegjet në investime dhe buxhet.

Decentralizimi i disa shërbimeve të ndryshme komunale nëpër fshatra dhe lagje të mëdha të qytetit si dhe qasja në internet për këto shërbime do të ishte një ndër veprimet e para të punës sime, pasi banorët e komunës nuk do të prisnin më në radhë të gjata për të marrë dokumentet e statusit civil si: letërnjoftim, pasaportë apo për të regjistruar një biznes.

Me qëllim të joshjes së investitorëve dhe bizneseve të ndryshme do të organizoja takime të karakterit informativ si dhe do të ftoja biznese me qëllim të informimit të tyre me potencialet e komunës, në këto takime do t’ju kisha ofruar mundësinë të gjithë atyre që dëshirojnë të hapin biznese brenda territorit të komunës, që tatimi në pronë për ta të përgjysmohej me qëllim që të punësoheshin sa më shumë persona.

Mbrojtja e mjedisit, marrja dhe përkrahja e iniciativave të ndryshme për pastrimin dhe gjelbërimin e hapësirave publike do të ishte një tjetër veprim që unë do ta bëja. Të gjitha datat e rëndësishme botërore për mbrojtjen e ambientit, ruajtjen e ujit, ditën e tokës etj., do t’i shëmoja me aktivitete të ndryshme edhe në komunën time pasi kostoja financiare e tyre nuk kushton shumë dhe mund të kenë efekt pozitiv në vetëdijësimin e banorëve për këto çështje.

Për çdo vit me vendimin timin dhe bashkërisht edhe të kuvendit komunal në konsultim edhe me

drejtorinë gjegjëse do të shpallej me mirënjohje oborri më i gjelbëruar, si dhe hapësira publike para lokaleve të ndryshme afariste si më e rregulluara.

Për luftimin e korrupsionit dhe të nepotizmit në Institucionet komunale do të bëja fushata të ndryshme e ndër to do ta kisha shfrytëzuar faqen zyrtare të komunës në Internet, si dhe vendosjen e kutive të vogla postare jashtë ndërtesës së komunës dhe në disa bashkësi lokale nëpër fshatra me qëllim që qytetarët direkt të më njoftonin mua por edhe policinë me rastet e korrupsionit dhe të nepotizmit nëpër institucione.

Formimi i Komiteteve Këshillëdhënëse, përfaqësimi gjinor, profesional dhe etnik do të ishte një fushë tjetër ku unë do të fokusohesha gjatë punës sime.

Duke ndërtuar dhe zhvilluar sipas planifikimit hapësinor dhe urbanistik të Komunës, dhe duke u dhënë mundësi të gjithë atyre që dëshirojnë të ndërtojnë çoftë ndërtesa banimi por edhe objekte tjera afariste do të eliminoja kaosin urbanistik por edhe do të krijoja më shumë hapësira publike për rekreacion si dhe do të ruaja nga shkatërrimi objekte të ndryshe kulturore të interesit shoqëror.

Ndër prioritetet e mia si njeriu i parë i komunës do të ishte edhe zhdukja e analfabetizmit si dhe krijimi i mundësive që në çdo shkollë të kishte edhe klasë për parashkollor si dhe tu mundësohej shkollimi dhe transportimi falas personave me nevoja të veçanta me qëllim që edhe ata ta ndjenin vetën si qytetarë të barabartë me të gjitha shtresat e tjera.

Po ashtu do të angazhohesha që në çdo institucion publik aty ku nuk ka të ndërtoreshin hyrje të veçanta për personat që janë në karroca dhe nuk mund të ecin.

Gjithashtu do të inicioja që komuna të formonte një fond me qëllim që t'i përkrahte organizatat e ndryshme jo qeveritare, aktivitetet rinore, kulturore, sportive si dhe artistët e ndryshëm me qëllim që ta përfaqësojnë sa më denjësisht komunën dhe vetën e tyre.

21

SALI SALIHU – “Sikur të isha kryetar komune”**(Mbi rëndësinë e raportimit profesional në administrimin e punëve publike në komunë)**

Ndonëse nuk më ka shkuar ndonjëherë mendja që të kandidoja për ndonjë post të zgjedhur, nuk mund të mohoj se nuk kam vrarë mendjen se pse diç gjëra nuk shkojnë ashtu siç do të doja unë, e besa jo rrallë, edhe për atë se si do të kisha vepruar unë në situata të caktuara. Dhe sa herë që diskutimet mbi mënyrën e administrimit të punëve publike marrin hov, qofshin sa për muhabet apo serioze, shpesh na rrëshqet refreni: “Sikur unë të isha

Kryetari...”.

Me kompetencat që ka sot, Kryetari i Komunës është në fakt udhëheqësi që i jep kahun drejtim të institucionit. Është ai nga i cili ne presim që të përvjel mëngët, të mos anashkaloj problemet që na mundojnë, t’i japë jetë bashkëveprimit me ne, e pse jo, edhe të na ofrojë mundësinë të bëhemi pjesë e zgjidhjeve. Në të shumtën e rasteve, hiç ato kritikën e ulëta prozaike në diskutimet e verdha bulevardeske, Kryetarin e vëmë në thumb, pjesërisht apo tërësisht, për mungesë vizioni, mungesë guximi për të adresuar çështje komplekse dhe të vështira, mungesë vetëbesimi, mungesë aftësish për organizim të brendshëm institucional, e çka jo tjetër. Me pak fjalë, kritikojmë për mungesën e aftësive udhëheqëse të një të zgjedhuri. Por, përgjithësisht rrallëherë lodhemi ta kuptojmë apo e kemi të vështirë të kuptojmë se ku qëndron në fakt problemi në menaxhimin e punëve publike që për nga natyra janë shumë më të ndërlikuara se ç’mund ta marrim me mend.

Në përgjithësi, Kryetarët e dalë nga zgjedhjet e nëntorit 2007 gjatë mandatit të tyre kanë shpenzuar mjaft energji në organizimin e brendshëm të administratës, qoftë si pasojë e ndryshimeve në kornizën ligjore apo gjendjes kaotike të cilën kanë trashëguar nga paraardhësit e tyre. Në këtë aspekt, kam përshtypjen se ndonëse është bërë mjaft në këtë drejtim, metodat me të cilat kanë arritur të imponojnë “një rend të ri funksional” nuk kanë qenë gjithmonë në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë. Pse e them këtë? E them sepse përvojat e mëhershme kanë treguar se udhëheqësit që janë treguar të suksesshëm në “shtërngimin e penjëve” brenda një organizate komplekse, zakonisht kanë dështuar në fazat pasuse të funksioneve udhëheqëse. Pra ekziston një “rrezik” dhe ky është një aspekt shumë i rëndësishëm të cilin dihet të kenë parasysh kryetarët e komunave në Kosovë. Kjo edhe për faktin se shumica prej tyre do të rikandidohen për të fituar një mandat të dytë.

Duke pasur afirmimet me pushtetin komunal, e për rrjedhojë edhe me sfidat me të cilat është përballur që nga fillimi, kam vërejtur se funksionet menaxhuese kanë vuajtur shumë dhe vazhdojnë edhe sot të vuajnë nga bashkërendimi jo fort efikas i komunikimit, qoftë horizontal apo vertikal. Me këtë rast do të ndalem tek ajo që unë e konsideroj më thelbësoren në aspektin e menaxhimit të punëve publike (dhe jo vetëm të tyre) – raportimin profesional. Sepse mungesat e këtij karakteri na e bëjnë punë lëmsh.

Raportimi profesional, para së gjithash, ka të bëjë me veprimin. Ky lloj raportimi duhet disajnuar që të sjell veprim, ndryshim, dhe së fundi, rezultate pozitive. Paraqitja e fakteve, analizat, sintezat, interpretimet, përfundimet, propozimet, janë etapa të raportimit. Raportimi profesional nuk është një veprim për të treguar se sa dimë. Një raport periodik (siç janë raportet e drejtorive komunale, për shembull) do të duhej përmbante informacion të mjaftueshëm, analizë të fakteve, shpjegime sintetike, konkluzat dhe rekomandime për veprime të mëtejme. Raportet e mira kanë një objektiv të qartë, organizim dhe paraqitje të mirë të ideve, gjuhë të qartë dhe koncizitet në formulim.

Raportimi profesional, pra, nuk ka të bëjë vetëm me informimin dhe ndarjen e informacionit me të tjerët.

Raportimi i organizuar mirë dhe profesionalisht është një instrument që garanton vazhdimësi në trajtimin e çështjeve me të cilat Kryetarët e Komunave duhet të merren ditë për ditë. Raportimi efikas u mundëson atyre që të kenë një mbikëqyrje të vazhdueshme dhe një pasqyrë më të qartë se çfarë po ndodh, çfarë ka ndodhur, apo edhe të kenë një parashikim mbi atë që mund të ndodh në të ardhmen. Raportet, poashtu, janë një mjet i dobishëm dhe referencë e korrekte në vlerësimin e efikasitetit të institucionit përmes ndërtimit të një relacioni real midis asaj që është synuar dhe asaj që është arritur. Në këtë kontekst, të shkruara në mënyrë të paanshme dhe objektive, dhe të analizuara dhe interpretuara profesionalisht, raportet shndërrohen në një instrument efektiv edhe për disajnimin e politikave, objektivave, dhe strategjive të reja.

Kryetari i Komunës dhe kabineti i tij do të duhej të përcaktoheshin për formatin dhe (shpeshtësinë) e raporteve të rregullta, të cilat besohet se mund të sjellin efikasitet dhe rezultate më të mira në funksionimin e administratës komunale. Në këtë drejtim, është thelbësore që kreu i administratës komunale të aplikojë raportimin ditor të karakterit informativ, raportimin e përdyjavshmen (ose mujor, varësisht nga nevoja) me karakter përshkrues-analitik, dhe raportimin periodik (çerekvjetor, gjysëmvetor dhe vjetor) me karakter rekomandues-strategjik.

Përveç raportimit të rregullt, kabineti i kryetarit mund (dhe duhet) të aplikojë edhe raportimin special – për shembull raportet e progresit mbi jetësimin e projekteve me interesa kapitale për komunën. Këto lloj raportesh mundësojnë që gjendja në jetësimin e projekteve të veçanta të jetë nën mbikëqyrje dhe kontroll të plotë. Raportet e progresit përveç informacionit mbi mbarëvajtjen e projektit, duhet të përmbajnë edhe analiza të veçanta të zhvillimeve, faktorët që mund të kërcënojnë mbarëvajtjen e projektit, si dhe rekomandime për tu përballuar me sfida të tilla eventuale.

Raportimi profesional, pra, është një mjet thelbësor në procesin e administrimit të punëve publike dhe aktualisht fiton një rëndësi edhe më të madhe duke pasur parasysh detyrimin për shkurtime të pashmangshme në personelin shërbimit civil në një të ardhme jo të largët. Aplikimin i një komunikimi efektiv përmes profesionalizimit të raportimit, thjeshtëson shumë drejtimin e punëve publike, dhe për më tepër, e shoh si një masë të shëndoshë për tu përballur me shkurtime në burimet njerëzore në perspektivë.

22

BEKIM HYLA – “Sikur të isha kryetar komune”

Duke u nisur nga fakti se qytetari është subjekt kryesor në ndërtimin e bashkësisë shoqërore dhe të drejtat dhe liritë e tij janë të patjetërsueshme atëherë edhe vizioni dhe strategjia ime do të nisin nga kjo pike.

Si parim kryesor në ndërtimin e strategjisë sime do të jetë respektimi i vullnetit të lirë të qytetarëve, krijimi i institucioneve të qëndrueshme, efikase dhe transparente të pushtetit në shërbim të qytetarit. Barazia para ligjit, e drejta e besimit fetar, e drejta e pronës, e arsimit dhe shprehja e lirë do të jenë udhërrëfyese im mbi të cilat do të buron çdo iniciativë dhe çdo vendim gjatë

punës im.

Sektorët në të cilat do të angazhohem maksimalisht do të jenë si vijon:

Drejtësia - duke u nisur nga fakti se sundimi i ligjit është gurthemel i ndërtimit të një shoqërie atëherë do të angazhohem në rritjen e përgjegjshmërisë së punëtorëve gjyqësor në shërbim të qytetarit.

Siguria - institucionet e sigurisë do të jenë gjithmonë në shërbim të qytetarit, e posaçërisht do të angazhohem që të rritet prania e policisë në institucionet shkollore.

Ekonomia - zhvillimi ekonomik i qytetit tim do të jetë një tjetër për mua. Do të angazhohem që të gjitha që të gjitha subjekteve që ndikojnë në zhvillimin ekonomik t’u ofrojë lehtësime (gjetja e lokacioneve, lehtësirave administrative dhe ofrimi i mbështetjes) për zhvillimin e bizneseve të tyre.

Arsimi - modernizimi i sistemit arsimor dhe rritja e pavarësisë së institucioneve arsimore (drejtorive të shkollave) dhe rritja e pjesëmarrjes në vendim marrje e nxënësve dhe prindërve do të jenë angazhimet e mia kryesore në këtë fushë.

Shëndetësia - përparimi i shëndetit të qytetarëve duke e vendosur pacientin në qendër të vëmendjes dhe modernizimi i shërbimeve shëndetësore do të jenë parimet bazë në këtë sektor. Angazhim të posaçëm do të kërkoj në zhvillimin e vizitave sistematike të fëmijëve nëpër çerdhe dhe nxënësve nëpër shkolla praktike kjo e harruar nga institucionet shëndetësore.

Ambienti - strategji kryesore do ta përdori angazhimin dhe fuqizimin e organizatave ambientaliste duke i inkurajuar dhe mbështetur financiarisht në realizimin e projekteve të tyre me theks të veçantë në mirëmbajtjen e shtratit të lumit Krena.

Shërbimet administrative - qëllim kryesor i punës sime do të jetë që çdo qytetare e posaçërisht mërgimtarët të pajisen me dokumentacion të nevojshëm brenda 24 orëve.

Lufta ndaj korrupsionit - për të ndaluar korrupsionin në institucionet komunale do të krijoj për çdo drejtori këshilla qytetare që do të marrin pjesë aktivisht në të gjitha vendimet dhe iniciativat që burojnë prej tyre.

Pjesëmarrja e qytetarëve në vendim marrje - çdo iniciativë dhe vendim madhor për komunën time do ta shtroj në diskutim publik përpara miratimit.

23

ISMET POTERA – “Sikur të isha kryetar komune”

Roli i individit në histori është dëshmuar shpesh se ka qenë vendimtar për ndryshime, shpeshherë, revolucionare. Kësi rastesh ka sa të duash nëpër botë. Po në Kosovë? Po në momentin aktual të zhvillimeve shoqërore? Po në komunën nga jam unë? Janë raste minore të ndryshimeve në të mirë të qytetarëve. Tek e fundit, pushteti, lidhshipi, si përfaqësues i votës së qytetarit detyrimisht duhet të jetë në funksion të votëdhënësit.

Moto imja do të jetë: çdo gjë në shërbim të qytetarit. Nga kjo del vizioni: ngritja e shkallës së cilësisë së shërbimeve komunale drejt përmirësimit të jetës së qytetarëve.

Realizimi i këtij vizioni dhe arritja e qëllimeve të udhëheqjes komunale do të realizohet me pjesëmarrje të lartë, cilësore e aktive, të palëve të interesuara.

Hapi i parë, i domosdoshëm, që do bëja në fushën e ngritjes së cilësisë së shërbimeve, është vendosja e përparësive në këtë fushë. Ato përparësi do t'i identifikonin vet qytetarët. Këtë do ta bëjë duke mbajtur kontakte të vazhdueshme me ta, jo në fazën parazgjedhore për të kërkuar votën e tyre, por menjëherë pas zgjedhjes sime. Rëndësia e kësaj qëndron në faktin dhe efektin që ka pjesëmarrja e qytetarit në vendosjen e prioriteteve për jetën e tij. Nëse ai, qytetari, është bashkëpjesëmarrës në ndërtimin e prioriteteve, ai do të marrë pjesën e përgjegjësisë edhe në fazën e zbatimit, por edhe në vlerësimin e rezultateve apo të dështimeve eventuale.

Prioritet mbi prioritet për komunën time është infrastruktura. Jo duke filluar nga qendra, ose rreth qendrës së qytetit, ku megjithatë ekziston një infrastrukturë, por nga fshati më i largët. Pa ndërtimin e infrastrukturës jashtë qytetit nuk mund ta mbash atë brenda në qytet. Deri më tani, thuaja të gjithë kryetarët janë marrë me “rregullimin” rreth shtëpisë (komunës), por asnjëri nuk e hoqi pluhurin dhe mbeturinat nga qyteti.

Ndërtimi i infrastrukturës nga periferia kah qendra (kupto nga vendbanimet më të largëta nga qyteti) do të ndikohej në ndaljen e migrimeve fshat-qytet. Këtë do ta arrija me rrugët, shërbimet e ujësjellësit, kanalizimit, mbeturinave dhe shërbimeve tjera administrative, shëndetësore e edukative, aty ku jeton qytetari.

Territori i komunës sime ka shumë pjesë dhe peizazhe të bukura. Ky është një resurs i mirë për zhvillimin e truizmit fshatar ekologjik dhe për zgjidhjen e problemeve sociale të qytetarëve. Më parë ka pasur të interesuar nga jashtë për të ndërtuar kapacitete turistike, si Tiroli i Austrisë, kompani nga Sllovenia... Kjo nuk është shfrytëzuar, por as nuk janë zgjidhur problemet sociale dhe të migrimit të qytetarëve. Ky është një prioritet, i cili duhet sa më shpejt të realizohet sepse kështu do zbuten problemet sociale-ekonomike.

Gjithashtu kjo pjesë ka burime shumë të pasura me kullota, të pashfrytëzuara deri tani. Blegtoaria është një degë shumë fitimprurëse dhe me perspektivë. Prodhimet e qumështit, jo vetëm që do të plotësonin nevojat e qytetarëve të komunës, por edhe shumë komunave tjera dhe për eksport. Vendet ideale për bagëti, sidomos dele e dhi, do të ndihmonin shumë në rritjen e mirëqenies sociale të qytetarëve. Shtimin e fondit të bagëtive do ta bëjë nëpërmjet kreditimit. Kreditimet nuk do bëhen si më parë, por secili përfitues do të marrë detyrime. Vlerësimi do bëhet në vazhdimësi. Por, edhe ndihma profesionale.

Zhvillimi i pemëtarisë ka mundësi të mira zhvillim dhe përmirësim të jetës qytetare. Merreni me mend se me çfarë çmimesh blihen pemët, mollët, dardhat e kumbullat, kur ato me pak kujdes e investim mund të sigurohen jo vetëm për banorët e komunës.

Administrata është një problem dhe maltretim për shumë qytetarë. Këtë do ta zgjidhja lehtë. Të gjithë qytetarëve do t'u mundësohet qasja në dosjet/dokumentet e veta: certifikata, pronësi... Ai me një qasje në internet, tani të gjitha fshatrat janë të mbuluara me të, do të marrë certifikatën. Shërbimi i ofiçarisë, pronësisë e kadastrës, vetëm do ta verifikoi e vulos atë. Për këtë do t trajnoja një ekip specialistësh, të cilët do të krijonin një softuer të tillë. Do të zvogëlohen pritjet para sporteve dhe shtohet cilësia shërbimeve.

Transparenca shprehet në fuqinë dhe qartësinë e objektivave të institucioneve komunale, por edhe të vetë kryetarit. E para, çdo qytetar do të informohet me kohë për shumën e buxhetit të komunës, për mjetet që duhet të grumbullohen nga tatimet etj. Ato mjete do të propozohen edhe nga përfaqësuesit e qytetarëve se për cilat prioritete do të shpenzohen. Për çdo projekt të filluar dhe për fazat e tij deri në përfundim, qytetari do të marrë informata të rrjedhshme dhe sa herë të paraqes interesim për to.

Asnjë projekt, i madh o i vogël, nuk do nisej pa diskutim publik dhe pa pjesëmarrje të tij në vendim-marrje, në pajtim me tri shtyllat e Konventës së Aarhusit.

Për çdo dyshim për korrupsion qytetari do të marrë informatë të saktë. Verifikimi do të bëhet nga kompetentët, por edhe me pjesëmarrje të përfaqësuesit të komunitetit.

AKK-ja ka statusin e vëzhguesit në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale në Evropë të Këshillit të Evropës. Është Anëtar i Përhershëm i NALAS-it (Rrjeta e Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës Jug-Lindore), anëtar i Rrjetit LOGIN, anëtar i Rrjetit LOGON dhe është në pozitën Asociacion i Ftuar (i ngjashëm me pozitën e anëtarit vëzhgues) në Komitetin Evropian të Komunave dhe Regjioneve (CEMR).

